

PROGRAM TRAJNIMI PËR MJEKË DENTISTË

TRAJTIMI ENDODONTIK I KANALEVE TË VËSHTIRA

MODULI II

*Instrumentimi, teknologjitë moderne, retrajtimi dhe menaxhimi
i komplikacioneve në trajtimin e kanaleve të vështira*

MATERIAL EDUKATIV PËR ZHVILLIM PROFESIONAL TË VAZHDUAR

Endodonci klinike e avancuar

PËRMBAJTJA

HYRJE

Tema 1. Instrumentimi dhe teknologjitë moderne në trajtimin e kanaleve të vështira

- 1.1 Instrumentet manuale (K-file, K-Reamer, H-file)
- 1.2 Instrumentet NiTi (nikël-titan)
- 1.3 Sistemet rotary dhe reciprocating
- 1.4 Apex locator
- 1.5 Mikroskopi operativ
- 1.6 Ultrasoniku në endodonci
- 1.7 Aktivizimi i irrigimit
- 1.8 Teknologjitë për obturim
- 1.9 Softuerët dhe planifikimi digjital

Tema 2. Komplikacionet në trajtimin e kanaleve të vështira dhe menaxhimi i tyre

- 2.1 – 2.11 Klasifikimi dhe të 10 komplikacionet kryesore proceduriale

Tema 3. Retrajtimi endodontik

- 3.1 – 3.6 Indikacionet, vlerësimi, protokoli klinik dhe prognoza

Tema 4. Irrigimi dhe dezinfektimi i avancuar i sistemit të kanaleve

- 4.1 – 4.6 NaOCl, EDTA, klorheksidina dhe protokoli final i irrigimit

Tema 5. Vlerësimi i rezultatit dhe suksesi afatgjatë i trajtimit endodontik

- 5.1 – 5.5 Kriteret e suksesit, faktorët prognostikë dhe ndjekja radiografike

HYRJJE

Ky modul i dytë vazhdon direkt nga parimet e paraqitura në Modulin I, duke u thelluar në dy shtylla thelbësore të praktikës endodontike bashkëkohore: instrumentimin dhe teknologjitë moderne, dhe menaxhimin sistematik të komplikacioneve proceduriale. Ndërsa Moduli I u fokusua në anatomi, klasifikim, diagnostikim dhe protokollin klinik të përgjithshëm, ky modul thellohet në aspektet teknike dhe operative që përcaktojnë suksesin real në karrigen dentare.

Zgjedhja e instrumentit të duhur — qoftë manual apo mekanik — ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e mjekut për të ruajtur anatominë origjinale të kanalit, për të minimizuar rrezikun e komplikacioneve dhe për të arritur një dezinfektim dhe obturim të suksesshëm. Njëkohësisht, edhe kur zbatohet protokollin më i kujdesshëm, komplikacionet proceduriale mbeten një mundësi reale në kanalet e vështira. Njohja e shkaqeve, e mekanizmave dhe e strategjive të menaxhimit të tyre është po aq e rëndësishme sa vetë parandalimi.

Ky modul shtrihet gjithashtu në tre fusha shtesë që plotësojnë ciklin e plotë të kujdesit endodontik: retrajtimin endodontik, si përgjigje ndaj dështimeve të trajtimit fillestar; irrigimin dhe dezinfektimin e avancuar, si komponent kimik i domosdoshëm përtej vetë instrumentimit mekanik; dhe vlerësimin e rezultatit afatgjatë, i cili mbyll ciklin klinik duke përcaktuar nëse trajtimi konsiderohet i suksesshëm.

Çfarë do të mësoni në këtë modul

Karakteristikat, dizajnin dhe indikacionet e instrumenteve manuale dhe mekanike NiTi, përfshirë sistemet rotary dhe reciprocating.

Rolin e teknologjive moderne — apex locator, mikroskop operativ, ultrasonik, softuerë digjitalë — në rritjen e saktësisë dhe sigurisë klinike.

Klasifikimin, etiologjinë, parandalimin dhe menaxhimin e komplikacioneve kryesore proceduriale.

Parimet e retrajtimit endodontik, protokollet e avancuara të irrigimit, dhe kriteret e vlerësimit të suksesit afatgjatë.

TEMA 1. INSTRUMENTIMI DHE TEKNOLOGJITË MODERNE NË TRAJTIMIN E KANALEVE TË VËSHIRA

Zhvillimet teknologjike në endodonci kanë transformuar ndjeshëm mënyrën e trajtimit të kanaleve të vështira. Përdorimi i instrumenteve moderne dhe i teknikave të avancuara ka rritur ndjeshëm suksesin klinik, duke reduktuar komplikacionet dhe duke përmirësuar efikasitetin e trajtimit.

1.1 Instrumentet manuale

Pavarësisht zhvillimit të sistemeve të instrumentimit mekanik prej nikël-titani (NiTi), instrumentet manuale vazhdojnë të përbëjnë bazën e trajtimit endodontik. Ato luajnë një rol kyç në eksplorimin e anatomisë së kanalit radikular, negocimin e kanaleve të ngushta ose të kalcifikuara, krijimin e një glide path të sigurt, ruajtjen e patencës apikale dhe verifikimin e gjatësisë së punës. Përdorimi korrekt i instrumenteve manuale rrit sigurinë e instrumentimit mekanik, ul incidencën e komplikacioneve procedurale dhe kontribuon në ruajtjen e anatomisë origjinale të kanalit.

Rëndësia biologjike dhe mekanike

Objektivi i instrumentimit manual nuk është vetëm zgjerimi i kanalit, por krijimi i kushteve optimale për dezinfektimin kimik dhe obturimin tridimensional të sistemit të kanaleve radikulare. Meqenëse instrumentet nuk prekin të gjitha sipërfaqet e kanalit — veçanërisht në kanalet me seksion oval ose me anatomi komplekse — instrumentimi manual duhet konsideruar pjesë e një protokollit ku veprimi mekanik kombinohet me irrigimin efektiv dhe aktivizimin e irrigantëve.

Nga pikëpamja biomekanike, instrumentet manuale duhet të:

- Respektojnë trajektoren origjinale të kanalit.
- Minimizojnë largimin e panevojshëm të dentinës.
- Ruajnë pozicionin e foramenit apikal.
- Krijojnë një konicitet progresiv që lehtëson irrigimin dhe obturimin.

Karakteristikat konstruktive

Instrumentet manuale përbëhen nga katër komponentë kryesorë:

- **Doreza (handle)** — e koduar sipas standardit ISO me ngjyra dhe numra për identifikimin e madhësisë.
- **Shanku (shank)** — lidh pjesën aktive me dorezën dhe transmeton forcat gjatë instrumentimit.
- **Pjesa aktive (flutes)** — përmban brazdat prerëse që realizojnë prerjen dhe largimin e dentinës.
- **Maja (tip)** — mund të jetë aktive ose joaktive, duke ndikuar në aftësinë prerëse dhe në rrezikun e devijimit të kanalit.

Karakteristikat e dizajnit — si seksioni transversal, këndi i helikës, numri i spiraleve dhe fleksibiliteti — ndikojnë drejtpërdrejt në efikasitetin prerës, rezistencën ndaj frakturës dhe aftësinë për të ndjekur lakimet e kanalit.




Figura 1.1 — Dizajni skematik i K-file, K-Reamer dhe H-file: numri dhe forma e spiraleve përcaktojnë kapacitetin prerës dhe fleksibilitetin.

Materiallet

Instrumentet manuale prodhohen kryesisht nga dy materiale:

- **1. Çeliku inox (Stainless Steel)** — karakterizohet nga rezistencë e lartë ndaj deformimit plastik dhe kapacitet i mirë prerës, por fleksibilitet relativisht i kufizuar, veçanërisht në instrumentet me diametër $\geq \#20$. Për këtë arsye, në kanalet me lakime të theksuara ekziston një rrezik më i madh për transportim të kanalit, formim ledge-sh, perforacione ose zip apikal.
- **2. Nikël-Titani (NiTi)** — shfrytëzon vetitë e superelasticitetit dhe efektit të memories, duke ofruar fleksibilitet shumë më të madh krahasuar me çelikun inox. Kjo u lejon instrumenteve të ndjekin më mirë anatominë natyrale të kanalit dhe të reduktojnë stresin mbi muret dentinare, megjithëse ndjesia taktile mund të jetë më e kufizuar dhe kapaciteti prerës disi më i ulët.

Standardizimi ISO

Sipas standardit ISO 3630, instrumentet manuale identifikohen nga:

- Diametri në majë (D_0), i shprehur në të qindtat e milimetrit.
- Koniciteti (zakonisht 0.02 mm/mm).
- Kodi i ngjyrës.
- Gjatësia totale (21, 25, 28 ose 31 mm).

Ky standard siguron uniformitet midis prodhuesve dhe lehtëson përzgjedhjen e instrumenteve gjatë procedurës klinike.

Klasifikimi

Instrumentet manuale klasifikohen sipas funksionit dhe dizajnit në: K-files, K-Reamers, Hedström files (H-files), C-files, Pathfinder files, Barbed broaches, dhe instrumente manuale NiTi për krijimin e glide path-it.

Instrumenti	Dizajni	Përdorimi kryesor
K-file	Përdredhje (twisting) e telit; seksion katror ose trekëndësh	Eksplorim, negocim, glide path, instrumentim standard
K-Reamer	Përdredhje me më pak spirale për njësi gjatësie	Zgjerim me lëvizje rrotulluese në kanale relativisht të drejta
H-file (Hedström)	Frezim (machined) i një teli cilindrik; seksion konik i mbivendosur	Zgjerim final, largim gutaperke në retrajtim, heqje debris

1.1.1 K-file

K-file është instrumenti manual më i përdorur në endodonci. Është projektuar për eksplorimin, negocimin, krijimin e glide path-it dhe instrumentimin e kanaleve radikulare. Për shkak të kombinimit të fleksibilitetit, rezistencës dhe kontrollit taktil, konsiderohet standardi i artë i instrumentimit manual.

K-file prodhohet duke përdredhur (twisting) një tel prej çeliku inox me seksion katror ose trekëndësh. Seksioni katror ka më shumë masë metalike dhe rezistencë më të lartë ndaj torsionit, por fleksibilitet më të ulët; seksioni trekëndësh është më fleksibël, ka kapacitet prerës më të madh dhe largon më mirë debris-in. Pjesa aktive përbëhet nga brazda spirale që presin dentinën dhe transportojnë debris-in drejt pjesës koronare.

K-file punon kryesisht me tre lloje lëvizjesh:

- Lëvizje watch-winding (30–60° rrotullime alternuese).
- Balanced force technique.
- Lëvizje të lehta filing (push-pull).

Teknika balanced force

E përshkruar nga James B. Roane, teknika balanced force konsiderohet metoda më efikase për instrumentimin e kanaleve të lakuara, pasi redukton transportimin e kanalit dhe stresin torsional mbi instrumentin.



Kufizimet e K-file

- Efikasitet prerës më i ulët se H-file.
- Në kanalet shumë të lakuara mund të shkaktojë transportim nëse përdoret në mënyrë agresive.
- Instrumentimi është më i ngadaltë se sistemet NiTi.

1.1.2 K-Reamer

K-Reamer është një instrument manual i projektuar kryesisht për zgjerimin (reaming) të kanalit radikular me lëvizje rrotulluese. Përdoret më pak se K-file, por mbetet i dobishëm në kanale relativisht të drejta. Prodhohet me të njëjtën metodë përdredhjeje si K-file, por me më pak spirale për njësi gjatësie, çka i jep kënd spirale më të madh, hapësirë më të madhe ndërmjet brazdave dhe kapacitet më të mirë për largimin e debris-it.

Reamer punon me futje pasive deri në gjatësinë e punës, rrotullim orar rreth $\frac{1}{4}$ – $\frac{1}{2}$ rrotullimi (90–180°), dhe tërheqje pa ushtruar forcë apikale — prerja realizohet gjatë rrotullimit, jo gjatë lëvizjeve lineare.

**Indikacionet dhe kufizimet**

- Indikohet në kanale të drejta, për zgjerim gradual të lumenit dhe në fazat fillestare të instrumentimit manual.
- Nuk rekomandohet në kanale me lakime të mëdha dhe ka kontroll taktil më të kufizuar krahasuar me K-file; përdoret rrallë në protokollet moderne.

1.1.3 Hedström File (H-file)

H-file është instrumenti manual me kapacitetin më të lartë prerës ndër instrumentet tradicionale. Përdoret kryesisht për zgjerimin final të kanalit, largimin e gutaperkës gjatë retrajtimit dhe heqjen e debris-it. Ndryshe nga K-file dhe Reamer, H-file nuk prodhohet me përdredhje, por frezohet (machined) nga një tel cilindrik çeliku inox, duke krijuar brazda shumë të thella, kënd prerës shumë agresiv dhe një seksion që i ngjan një serie konësh të mbivendosur.

Kujdes klinik i domosdoshëm

H-file pret vetëm gjatë tërheqjes (pull stroke). Nëse rrotullohet brenda kanalit, rritet ndjeshëm stresi torsional dhe shtohet rreziku i bllokimit dhe frakturës — për këtë arsye, nuk rekomandohen rrotullime të plota me H-file.

**Indikacionet e H-file**

- Instrumentimi final manual dhe zgjerimi selektiv i pjesës koronare/mesme.
- Largimi i gutaperkës në retrajtim dhe heqja e mbetjeve organike.

Në praktikën moderne endodontike, K-file mbetet instrumenti manual më i rëndësishëm për eksplorimin, negocimin dhe krijimin e një glide path-i të sigurt. K-Reamer përdoret kryesisht për zgjerim me lëvizje rrotulluese në kanale të drejta, ndërsa H-file ofron efikasitetin më të madh prerës, por kërkon përdorim të kujdesshëm vetëm me lëvizje tërheqëse për të minimizuar rrezikun e frakturës. Kombinimi racional i këtyre instrumenteve, i integruar me irrigimin efektiv dhe instrumentimin mekanik NiTi, siguron ruajtjen e anatomisë origjinale të kanalit dhe përmirëson rezultatet biologjike dhe klinike të trajtimit endodontik.

1.2 Instrumentet NiTi (nikël-titan)

Futja e instrumenteve prej nikël-titani (NiTi) përbën një nga zhvillimet më të rëndësishme në endodoncinë moderne. Krahasuar me instrumentet tradicionale prej çeliku inox, NiTi ofron fleksibilitet dukshëm më të madh, rezistencë më të mirë ndaj deformimit elastik dhe aftësi superiore për të ndjekur anatominë tridimensionale të kanalit radikular. Këto karakteristika kanë reduktuar ndjeshëm incidencën e gabimeve procedurale — si transportimi i kanalit, formimi i ledge-ve, zip-i apikal dhe perforacionet — duke mundur një preparim më konservativ dhe më të parashikueshëm.

Përbërja metalurgjike

Instrumentet NiTi prodhohen nga një aliazh që përmban afërsisht 55% nikël dhe 45% titan, i njohur si Nitinol (Nickel Titanium Naval Ordnance Laboratory). Karakteristikat unike të NiTi burojnë nga transformimi i fazave kristalore midis austenitit dhe martensitit — një transformim përgjegjës për vetitë biomekanike që nuk gjenden te çeliku inox.

Vetitë kryesore

- **1. Superelastiteti** — aftësia e instrumentit për t'u deformuar në mënyrë elastike gjatë kalimit në kanale të lakuara dhe për t'u rikthyer në formën origjinale pas largimit të forcës. Klinikisht, kjo redukton transportimin e kanalit, ruan kurbaturën natyrale dhe zvogëlon stresin mbi dentinën.
- **2. Efekti i memories së formës** — në temperatura të caktuara, instrumenti rikthehet në konfigurimin fillestar pas deformimit. Kjo veti shfrytëzohet veçanërisht në instrumentet e trajtuara termikisht (heat-treated files).
- **3. Fleksibiliteti** — instrumentet NiTi janë 2–3 herë më fleksibël se ato prej çeliku inox. Kjo ul forcat anësore mbi muret e kanalit, redukton devijimet anatomike dhe lehtëson instrumentimin e kanaleve me kurbatura të dyfishta ose të theksuara.

Vetitë mekanike

Performanca klinike e instrumenteve NiTi varet nga disa faktorë të ndërlidhur:

- Fleksibiliteti.
- Rezistenca ndaj lodhjes ciklike (cyclic fatigue).
- Rezistenca ndaj stresit torsional.
- Dizajni i seksionit transversal.
- Koniciteti (taper).
- Trajtimi termik i aliazhit.

Lodhja ciklike (Cyclic Fatigue)

Kur instrumenti rrotullohet në një kanal të lakuar, i nënshtrohet cikleve të vazhdueshme kompresioni në anën konkave dhe tensioni në anën konvekse. Pas shumë cikleve, mund të ndodhë fraktura pa deformim të dukshëm paraprak — kjo e bën rezistencën ndaj lodhjes ciklike një nga parametrat më të rëndësishëm për sigurinë klinike.

Fraktura torsionale

Ndodh kur maja e instrumentit bllokohet brenda kanalit ndërsa motori vazhdon të aplikojë moment rrotullues (torque). Kur ky moment tejkalon kufirin elastik të aliazhit, ndodh fraktura. Faktorët predispozues përfshijnë mungesën e glide path-it, presionin e tepërt apikal, ripërdorimin e instrumenteve, dhe kanalet shumë të ngushta ose të kalcifikuara.

Trajtimet termike të NiTi

Për të përmirësuar performancën mekanike, prodhuesit kanë zhvilluar aliazhe të modifikuara me trajtime termike, si M-Wire, CM Wire (Controlled Memory), Gold Wire, Blue Wire dhe FireWire. Këto teknologji rrisin fleksibilitetin dhe rezistencën ndaj lodhjes ciklike, duke ulur rrezikun e frakturës.

Klasifikimi i instrumenteve NiTi

- **Instrumente manuale NiTi** — përdoren kryesisht për krijimin e glide path-it dhe ofrojnë fleksibilitet superior ndaj file-ve manuale prej çeliku inox.

- **Instrumente mekanike NiTi** — ndahen në sisteme me rotacion të vazhdueshëm (continuous rotation), sisteme me lëvizje reciproke (reciprocation), dhe sisteme adaptive që kombinojnë të dy mekanizmat.

Avantazhet dhe kufizimet klinike

- Avantazhet: ruajnë anatominë origjinale të kanalit, ulin incidencën e transportimit dhe perforacioneve, mundësojnë preparim më konservativ, reduktojnë kohën e instrumentimit, përmirësojnë efikasitetin e irrigimit dhe obturimit.
- Kufizimet: rrezik për frakturë nga lodhja ciklike ose torsionale, kosto më e lartë, kërkojnë respektim rigoroz të protokollit klinik, dhe nuk zëvendësojnë krijimin e një glide path të sigurt me instrumente manuale.

Instrumentet NiTi kanë transformuar endodoncinë moderne falë vetive të tyre metalurgjike dhe biomekanike. Megjithatë, suksesi klinik nuk varet vetëm nga materiali, por nga kombinimi i një glide path të mirë, irrigimit efektiv, respektimit të parametrave të motorit (shpejtësia dhe torque) dhe njohjes së kufizimeve të secilit sistem.

1.3 Sistemet rotary dhe reciprocating

Sistemet rotary NiTi përfaqësojnë standardin aktual të instrumentimit mekanik të kanaleve radikulare. Përdorimi i tyre ka revolucionarizuar preparimin endodontik duke rritur efikasitetin, reduktuar kohën e trajtimit dhe përmirësuar ruajtjen e anatomisë origjinale të kanalit. Megjithatë, instrumentimi rotary nuk zëvendëson parimet bazë të endodoncisë: suksesi klinik varet nga krijimi paraprak i një glide path-i, irrigimi efektiv, kontrolli i gjatësisë së punës dhe përdorimi korrekt i parametrave të motorit (shpejtësia dhe torque).

Parimi i funksionimit

Sistemet rotary përdorin instrumente NiTi që rrotullohen në mënyrë të vazhdueshme 360° me anë të një motori endodontik me kontroll të shpejtësisë dhe momentit rrotullues (torque). Gjatë rotacionit, brazdat prerëse largojnë dentinën dhe transportojnë debris-in në drejtim koronar, duke krijuar një preparim konik (tapered preparation) që favorizon irrigimin dhe obturimin.




Figura 1.2 — Krahësimi i kinematikës: rrotullim i vazhdueshëm (kënd rrotullimi rritet linearisht) kundrejt lëvizjes reciprokante (alternim asimetrik i drejtimit).

Sistemet rotary synojnë të:

- Ruajnë trajektoren origjinale të kanalit.
- Krijojnë një konicitet progresiv dhe të vazhdueshëm.
- Minimizojnë largimin e panevojshëm të dentinës.
- Reduktojnë transportimin apikal dhe devijimet anatomike.
- Lehtësojnë penetrimin dhe aktivizimin e irrigantëve.
- Krijojnë kushte optimale për obturim tridimensional.

Karakteristikat e dizajnit

- **Seksioni transversal** — trekëndor, katror, S-shaped, paralelogram, rectangular offset, ose dizajne të tjera të modifikuara, të cilat ndikojnë në efikasitetin prerës, fleksibilitetin, rezistencën ndaj lodhjes ciklike dhe largimin e debris-it.
- **Koniciteti (taper)** — ndryshe nga instrumentet manuale me taper standard 0.02, sistemet rotary ofrojnë taper të ndryshëm (.04, .06, .07, .08, ose taper variabël progresiv/regresiv). Një taper më i madh përmirëson aksesin për irrigim, por rrit largimin e dentinës dhe mund të dobësojë rrënjën nëse përdoret pa kriter.
- **Pitch** — distanca ndërmjet dy spiraleve të njëpasnjëshme. Një pitch i ndryshueshëm redukton tendencën e instrumentit për t'u "vidhosur" (screw-in effect) dhe përmirëson evakuimin e debris-it.
- **Maja e instrumentit** — shumica e sistemeve moderne kanë majë joaktive (non-cutting tip), çka redukton rrezikun e ledge-ve, minimizon transportimin dhe ndihmon instrumentin të ndjekë anatominë natyrale të kanalit.

Parametrat e motorit

Çdo sistem rotary ka parametra të rekomanduar nga prodhuesi — shpejtësinë e rotacionit (rpm) dhe momentin rrotullues (torque). Respektimi i këtyre parametrave është thelbësor për të reduktuar rrezikun e frakturës.

Teknikat e përdorimit

Instrumentet rotary nuk duhet të përdoren me presion apikal. Rekomandohet:

- Krijimi paraprak i glide path-it.
- Irrigim i bollshëm.
- Rikapitulim periodik me K-file #10 ose #15.
- Pastrim i shpeshtë i brazdave të instrumentit.
- Përdorimi i lëvizjeve të shkurtra "pecking motion" (2–3 mm), pa e detyruar instrumentin drejt apeksit.

Avantazhet dhe kufizimet e instrumentimit rotary

- Avantazhet: reduktojnë kohën e instrumentimit, ofrojnë preparim më të standardizuar, ruajnë më mirë kurbaturën e kanalit, reduktojnë incidencën e transportimit, përmirësojnë efikasitetin e irrigimit dhe zvogëlojnë lodhjen operatoriale.
- Kufizimet: mund të pësojnë frakturë nga lodhja ciklike ose stresi torsional, kërkojnë krijimin paraprak të glide path-it, dhe janë më pak efektive në kanale shumë të kalcifikuara pa negociim manual.

Klasifikimi i sistemeve rotary

Kategoria	Përshkrimi
Sisteme me sekuencë të plotë	Përdorin disa instrumente me madhësi dhe taper progresiv
Sisteme me një instrument (single-file)	Realizojnë preparimin me një instrument të vetëm ose sekuencë shumë të shkurtër
Sisteme me taper konstant / variabël	Diferencohen sipas ndryshimit të konicitetit përgjatë gjatësisë
Sisteme konvencionale / me trajtim termik	NiTi konvencional kundrejt aliazeve heat-treated (M-Wire, CM-Wire etj.)

Instrumentimi rotary është një komponent thelbësor i endodontisë moderne, por duhet të integrohet në një protokoll biologjik dhe biomekanik që përfshin krijimin e një glide path-i të sigurt, irrigimin aktiv dhe kontrollin rigoroz të parametrevë të punës.

1.4 Apex locator

Përcaktimi i saktë i gjatësisë së punës (working length) është një nga faktorët më kritikë për suksesin e trajtimit endodontik. Instrumentimi dhe obturimi duhet të kufizohen brenda sistemit të kanalit radikular, duke respektuar kufirin biologjik apikal, në mënyrë që të minimizohet dëmtimi i indeve periapikale dhe të optimizohet shërimi.

Megjithatë radiografia periapikale mbetet një metodë e rëndësishme, ajo ofron vetëm një imazh dy-dimensionale dhe nuk mund të lokalizojë me saktësi pozicionin e foramenit apikal ose të ngushtimit apikal (apical constriction). Për këtë arsye, apex locatorët elektronikë janë bërë pjesë integrale e praktikës moderne endodontike — pajisje elektronike që përcaktojnë pozicionin e majës së instrumentit brenda kanalit duke matur ndryshimet në impedancën elektrike midis instrumentit dhe një elektrode të vendosur në mukozën orale.

Baza biologjike

Pika ideale e përfundimit të preparimit dhe obturimit është ngushtimi apikal (apical constriction), i cili zakonisht ndodhet rreth 0.5–1.0 mm koronalisht nga forameni apikal, megjithëse kjo distancë ndryshon sipas anatomisë dhe moshës së pacientit. Apex locator-i nuk identifikon drejtpërdrejt ngushtimin apikal; ai identifikon me saktësi zonën e foramenit apikal, mbi bazën e ndryshimeve elektrike në indet përreth. Klinikisti më pas përcakton gjatësinë e punës duke u tërhequr zakonisht 0.5 mm nga kjo pikë.

Gjenerata	Karakteristika
Gjenerata I	Matja e rezistencës elektrike; saktësi e kufizuar
Gjenerata II	Matja e impedancës
Gjenerata III	Përdorimi i dy frekuencave
Gjenerata IV–V	Analiza multifrekuencë dhe algoritme të avancuara; saktësi shumë e lartë

Në praktikën bashkëkohore përdoren pothuajse ekskluzivisht pajisje të gjeneratës së fundit, të cilat mbajnë saktësinë e larta edhe në prani të irrigantëve si NaOCl ose EDTA.

Studimet klinike dhe meta-analizat tregojnë se apex locatorët modernë arrijnë një saktësi shumë të lartë (shpesh mbi 90–95% brenda ± 0.5 mm nga forameni apikal), veçanërisht kur përdoren në kombinim me radiografinë dhe respektohen protokollet klinike. Saktësia mund të ndikohet nga perforacionet radikulare, resorbimet apikale ose të brendshme, foramenet apikale shumë të gjera, prania e restaurimeve metalike në kontakt me instrumentin, dhe kanalet e bllokuara ose të pakalueshme.

**Avantazhet dhe kufizimet**

- Avantazhet: përcaktim më i saktë i gjatësisë së punës, reduktim i numrit të radiografive, monitorim në kohë reale, rritje e sigurisë biologjike, veçanërisht i dobishëm në anatomi komplekse dhe gjatë retrajtit.
- Kufizimet: nuk zëvendëson plotësisht radiografinë diagnostike; rezultatet duhet interpretuar gjithmonë në kontekstin klinik; kujdes në rastet me resorbim apikal të avancuar ose perforacione.

Standardi aktual i kujdesit është kombinimi i apex locator-it me interpretimin klinik dhe radiografinë periapikale, pasi asnjë metodë e vetme nuk garanton saktësi absolute në të gjitha situatat klinike.

1.5 Mikroskopi operativ

Mikroskopi operativ (Dental Operating Microscope – DOM) konsiderohet një nga inovacionet më të rëndësishme në endodoncinë moderne. Integrimi i zmadhimit optik dhe ndriçimit koaksial ka transformuar trajtimin endodontik nga një procedurë e bazuar kryesisht në ndjesinë taktile në një procedurë me kontroll të drejtpërdrejtë vizual.

Mikroskopi kombinon zmadhimin optik (zakonisht nga 3× deri në 30×) me ndriçimin koaksial me dritë LED ose Xenon, ku rrezja e dritës është paralele me boshtin optik të mikroskopit. Kjo eliminon hijet dhe siguron vizualizim të thellë të kavitetit të aksesit dhe kanalit radikular, duke mundësuar identifikimin e strukturave anatomike që nuk janë të dukshme me sy të lirë ose me lupat dentare.

Mikroskopi operativ përmirëson ndjeshëm aftësinë e operatorit për të:

- Lokalizuar kanalet shtesë (p.sh. MB2 në molarët e sipërm).
- Identifikuar kanale të kalcifikuara.
- Diagnostikuar frakturat vertikale të rrënjës.
- Evidentuar perforacionet dhe resorbimet.
- Larguar instrumentet e frakturuara.
- Menaxhuar retrajtimet komplekse dhe kryer kirurgji endodontike me precizion më të lartë.



Indikacionet kryesore

- Trajtimet endodontike komplekse dhe retrajtimet.
- Lokalizimi i kanaleve të fshehura dhe heqja e instrumenteve të frakturuara.
- Riparimi i perforacioneve dhe kirurgjia apikale.
- Diagnostikimi i çarjeve dhe frakturave dentare.

Avantazhet klinike

- **1. Diagnozë më e saktë** — zmadhimi mundëson identifikimin e detajeve anatomike dhe patologjike që nuk dallohen me sy të lirë.
- **2. Trajtim minimal invaziv** — vizualizimi më i mirë lejon preparime më konservative, duke ruajtur më shumë dentinë.
- **3. Rritje e suksesit klinik** — studimet tregojnë rritje të shkallës së lokalizimit të kanaleve shtesë dhe përmirësim të rezultateve në retrajtime dhe kirurgji.
- **4. Ergonomia** — mikroskopi ndihmon operatorin të punojë në pozicion më ergonomik, duke reduktuar lodhjen muskulare.
- **5. Dokumentimi** — shumë mikroskopë modernë janë të pajisur me kamera dixhitale për dokumentim klinik dhe mësimdhënie.



Kufizimet

- Kosto e lartë e pajisjes dhe nevojë për trajnim specifik në përdorim.
- Kërkon organizim të mirë të fushës operative dhe punë me asistencë me katër duar.

Rekomandim profesional

Mikroskopi operativ konsiderohet standardi i artë në endodoncinë moderne dhe rekomandohet nga organizata profesionale si European Society of Endodontology dhe American Association of Endodontists për procedurat endodontike komplekse.

Mikroskopi operativ nuk është thjesht një mjet zmadhues, por një teknologji që përmirëson diagnostikën, rrit precizionin e trajtimit dhe mbështet konceptin e mikroendodoncisë, ku ruajtja maksimale e strukturës dentare dhe respektimi i anatomisë së sistemit të kanaleve radikulare janë objektiva kryesore.

1.6 Ultrasoniku në endodonci

Përdorimi i ultrasonikut ka transformuar endodoncinë moderne duke rritur precizionin e trajtimit dhe efikasitetin e dezinfektimit të sistemit të kanaleve radikulare. Sot, ultrasoniku nuk përdoret vetëm për preparimin e kavitetit të aksesit, por edhe për aktivizimin e irrigantëve, lokalizimin e kanaleve të

kalcifikuara, heqjen e instrumenteve të fraktuara, retrajtimet dhe kirurgjinë endodontike. Integrimi i ultrasonikut me mikroskopin operativ dhe instrumentimin NiTi përfaqëson një nga standardet aktuale të endodoncisë minimale invazive.

Parimi i funksionimit

Instrumentet ultrasonike punojnë me frekuenca të larta, zakonisht 25–40 kHz, duke shndërruar energjinë elektrike në vibracione mekanike të amplitudës së ulët. Në endodonci përdoren kryesisht dy lloje sistemesh: piezoelektrike (vibrim linear, efikasitet më i lartë, më të përdorurat) dhe magnetostriktive (vibrim eliptik ose orbital, me prodhim më të madh nxehtësie dhe përdorim më të kufizuar).

Mekanizmat e veprimit

- **1. Rrymat akustike (Acoustic Streaming)** — vibracionet e majës ultrasonike krijojnë lëvizje të shpejta të irrigantit brenda kanalit, duke rritur kontaktin e irrigantit me muret e kanalit, përmirësuar depërtimin në kanalet laterale, isthmuset dhe tubulat dentinare, dhe lehtësuar largimin e debris-it dhe biofilmit. Ky është mekanizmi më i rëndësishëm klinik.
- **2. Kavitacioni (Cavitation)** — vibracionet mund të gjenerojnë mikrofluska që formohen dhe kolapsojnë në irrigant, duke krijuar energji lokale që ndihmon në shpërbërjen e biofilmit. Shumica e studimeve tregojnë se acoustic streaming mbetet mekanizmi dominues gjatë aktivizimit të irrigantëve.

Indikacionet klinike

- **1. Preparimi i kavitetit të aksesit** — majat ultrasonike mundësojnë preparim minimal invaziv, heqje selektive të dentinës dhe ruajtje më të mirë të strukturës dentare.
- **2. Lokalizimi i kanaleve të kalcifikuara** — në kombinim me mikroskopin operativ, lejon heqjen e kontrolluar të dentinës reaktive pa dëmtuar strukturat përreth.
- **3. Aktivizimi pasiv i irrigantëve (PUI)** — aplikimi më i rëndësishëm i ultrasonikut në endodonci; maja ultrasonike nuk prek muret e kanalit, por vibron lirshëm brenda irrigantit, duke rritur ndjeshëm efektin dezinfektues.
- **4. Heqja e instrumenteve të fraktuara** — majat ultrasonike përdoren për të ekspozuar dhe liruar instrumentin e fraktuar me humbje minimale të dentinës, zakonisht nën mikroskop operativ.
- **5. Ritrajtimi endodontik** — ndihmon në heqjen e gutaperkës, eliminimin e cementeve endodontike dhe pastrimin e zonave të paarrtshme me instrumente.
- **6. Kirurgjia endodontike** — në kirurgjinë apikale, majat ultrasonike përdoren për preparimin retrograd të kavitetit, krijimin e një preparimi në bosht me kanalin, dhe ruajtjen maksimale të dentinës.

Passive Ultrasonic Irrigation (PUI)

Studimet kanë treguar se PUI përmirëson largimin e smear layer, redukton ngarkesën bakteriale, përmirëson pastrimin e isthmuseve dhe kanaleve anësore, dhe rrit efektivitetin e NaOCl dhe EDTA.

**Avantazhet dhe kufizimet**

- Avantazhet: përmirëson dezinfektimin, rrit efikasitetin e irrigantëve, lejon preparim minimal invaziv, përmirëson vizibilitetin dhe kontrollin klinik, ul nevojën për heqje të panevojshme të dentinës.
- Kufizimet: efektiviteti varet nga krijimi paraprak i një preparimi adekuat; maja duhet të lëvizë lirshëm (kontakti me muret ul efektivitetin); përdorimi i zgjatur pa ftohje mund të shkaktojë rritje të temperaturës; kërkon trajnim dhe përvojë klinike.

Studime laboratorike dhe klinike kanë treguar se PUI është më efektiv se irrigimi konvencional me shiringë në largimin e debris-it, smear layer-it dhe biofilmit bakterial, veçanërisht në anatominë komplekse. Megjithatë, asnjë metodë aktivizimi nuk siguron pastrim të plotë të të gjitha sipërfaqeve, prandaj rekomandohet kombinimi i instrumentimit mekanik, irrigimit kimik dhe aktivizimit ultrasonik.

1.7 Aktivizimi i irrigimit

Efektiviteti i irrigimit rritet ndjeshëm kur solucionet aktivizohen, në vend që të lihen pasive brenda kanalit. Metodat kryesore të aktivizimit përfshijnë atë ultrasonike (e detajuar në seksionin 1.6), sonike, dhe manuale (agjitacion me kon gutaperke ose file). Irriguesit kryesorë të përdorur në kombinim me këto teknika mbeten hipokloriti i natriumit (NaOCl) dhe EDTA.

Qëllimi i aktivizimit

Objektivi kryesor i aktivizimit të irrigimit është penetrimi në zona anatomikisht të paarritshme nga instrumentet mekanike (isthmuse, kanale laterale, delta apikale) dhe eliminimi sa më i plotë i biofilmit bakterial rezidual. Ky proces trajtohet në thellësi në Temën 4 të këtij moduli.

1.8 Teknologjitë për obturim

Obturimi përfaqëson fazën përfundimtare të trajtimit endodontik dhe ka për qëllim krijimin e një mbushjeje tridimensionale, hermetike dhe të qëndrueshme të sistemit të kanaleve radikulare. Një obturim i suksesshëm duhet të parandalojë riinfektimin e kanalit, të izolojë bakteret reziduale dhe të krijojë kushte të favorshme për shërimin e indeve periapikale. Pavarësisht zhvillimit të materialeve dhe pajisjeve të reja, suksesi i obturimit varet kryesisht nga cilësia e instrumentimit biomekanik dhe dezinfektimit — obturimi nuk mund të kompensojë një pastrim të pamjaftueshëm të kanalit.

Një obturim ideal duhet të:

- Mbyllë tridimensionalisht sistemin e kanaleve radikulare.
- Izolojë kanalin nga mikroorganizmat dhe lëngjet indore.
- Mbushë kanalin kryesor, kanalet laterale dhe irregularitetet anatomike, sa të jetë e mundur.
- Sigurojë stabilitet dimensional dhe biokompatibilitet.
- Lejojë, kur është e nevojshme, retrajtimin.

Sistemet moderne të obturimit përbëhen nga materiali bazë (zakonisht gutaperka) dhe sealer-i endodontik, i cili mbush hapësirat midis gutaperkës dhe mureve të kanalit. Sot përdoren sealerë me bazë epoksi, silikoni, qelqi jonomer, dhe biokeramike — të cilët ofrojnë biokompatibilitet të lartë, stabilitet dimensional dhe aftësi bioaktive.

Teknika	Karakteristikat kryesore
Kondensimi lateral i ftohtë	Teknikë tradicionale, e parashikueshme, me kontroll të mirë të gjatësisë; adaptim i kufizuar në anatomi komplekse
Kondensimi vertikal me gutaperkë të ngrohtë	Përshkruar nga Herbert Schilder; adaptim superior, por teknikë komplekse me rrezik ekstrudimi
Injeksioni i gutaperkës së ngrohtë	Adaptim shumë i mirë në anatomi të parregullt; kontroll më i vështirë i gjatësisë
Teknika me një kon (Single-Cone)	E shpejtë dhe e riprodhueshme, veçanërisht e përshtatshme me sealerë biokeramikë
Sistemet termoplastike	Rrjedhshmëri e përmirësuar; pajisje elektronike për ngrohje/kondensim dhe injeksion të kontrolluar
Evidenca shkencore Teknikat me gutaperkë të ngrohtë ofrojnë adaptim më të mirë ndaj mureve të kanalit dhe mbushje më të mirë të anatomisë komplekse krahasuar me kondensimin lateral. Megjithatë, kur preparimi biomekanik dhe dezinfektimi janë kryer siç duhet, shkalla e suksesit klinik afatgjatë është e ngjashme ndërmjet teknikave të ndryshme. Faktorët biologjikë (eliminimi i infeksionit dhe mbyllja koronare) kanë ndikim më të madh në prognozë sesa vetë zgjedhja e teknikës së obturimit.	

1.9 Softuerët dhe planifikimi digjital

Transformimi digjital i stomatologjisë ka ndikuar ndjeshëm edhe në endodonci. Integrimi i imazherisë tredimensionale (CBCT), mikroskopisë operative, inteligjencës artificiale dhe softuerëve të avancuar të analizës ka mundësuar një qasje më të saktë, më të parashikueshme dhe minimalisht invazive në diagnostikimin dhe trajtimin e patologjive endodontike. Planifikimi digjital nuk zëvendëson gjykimin klinik të operatorit, por shërben si mjet mbështetës për marrjen e vendimeve të bazuara në evidencë.

Roli i softuerëve në endodonci

- **Analiza e imazheve CBCT** — rindërtim multiplanar (aksial, sagital, koronal) dhe tridimensional, matje të sakta lineare dhe këndore, identifikimi i kanaleve shtesë, resorbimeve, perforacioneve dhe frakturave.

- **Planifikimi i kavitetit të aksesit** — analiza tridimensionale ndihmon në përcaktimin e trajektores optimale, ruajtjen maksimale të dentinës pericervikale dhe reduktimin e rrezikut të perforacioneve — baza e aksesit minimal invaziv.
- **Endodoncia e udhëhequr (Guided Endodontics)** — kombinimi i CBCT-së, skanimit intraoral, softuerëve CAD dhe printimit 3D mundëson projektimin e guidave kirurgjikale për akses të kontrolluar në kanale të kalcifikuara, raste me anatomi komplekse dhe retrajtime të vështira, duke reduktuar humbjen e dentinës dhe rrezikun e devijimit.

Inteligjenca artificiale (AI)

Softuerët me AI po përdoren gjithnjë e më shumë për zbulimin automatik të lezioneve periapikale, identifikimin e kanaleve shtesë, analizën e morfologjisë radikulare, dhe asistimin në interpretimin e CBCT dhe radiografive. Megjithatë, AI nuk zëvendëson ekspertizën e klinikistit dhe kërkon gjithmonë interpretim profesional.

Në praktikën endodontike përdoren platforma të ndryshme për analizën e imazheve dhe planifikimin, si Romexis, CS 3D Imaging, Invivo, Blue Sky Plan, dhe 3D Slicer (kryesisht për kërkim dhe analiza të avancuara), të cilat ofrojnë mjete për segmentim anatomik, matje, planifikim dhe dokumentim klinik.



Avantazhet dhe kufizimet

- Avantazhet: diagnostikë më e saktë, vizualizim tridimensional, planifikim më i sigurt, reduktim i komplikacioneve, trajtim minimal invaziv, komunikim më i mirë me pacientin.
- Kufizimet: kosto e lartë, nevojë për trajnim specifik, ekspozim ndaj rrezatimit në rastin e CBCT (duhet respektuar parimi ALADAIP), dhe varësi nga cilësia e të dhënave të imazherisë.

Planifikimi digjital është bërë një komponent thelbësor i endodoncisë moderne. Integrimi i CBCT-së, softuerëve të analizës së imazheve, inteligjencës artificiale dhe teknologjive CAD/CAM rrit saktësinë diagnostike dhe mbështet një qasje minimalisht invazive — por këto teknologji mbeten mjete mbështetëse të vendimmarrjes klinike, jo zëvendësim i njohurive biologjike, biomekanike dhe përvojës së operatorit.



Pikat kyçe

- Instrumentet manuale mbeten thelbësore për glide path, negocim dhe ruajtje të patencës apikale, edhe në epokën e sistemeve NiTi mekanike.
- Superelasticiteti dhe efekti i memories së formës e bëjnë NiTi-n superior ndaj çelikut inox, por rreziku i lodhjes ciklike dhe frakturës torsionale kërkon respektim rigoroz të protokollit.
- Apex locator-i, mikroskopi operativ dhe ultrasoniku janë tre teknologji plotësuese që rrisin ndjeshëm saktësinë dhe sigurinë e trajtimit të kanaleve të vështira.
- Planifikimi digjital dhe endodoncia e udhëhequr po zgjerojnë vazhdimisht kufirin e trajtimeve minimale invazive, por mbeten mjete mbështetëse, jo zëvendësuese, të gjykimit klinik.

TEMA 2. KOMPLIKACIONET NË TRAJTIMIN E KANALEVE TË VËSHHIRA DHE MENAXHIMI I TYRE

Trajtimi i kanaleve të vështira shoqërohet me një rrezik më të lartë për komplikacione procedurale. Këto komplikacione mund të ndodhin gjatë çdo faze të trajtimit dhe, nëse nuk menaxhohen siç duhet, mund të çojnë në dështim të trajtimit endodontik.

2.1 Klasifikimi i komplikacioneve

Komplikacionet ndahen në dy kategori kryesore:

- **Procedurale (iatrogjene)** — ledge, perforim, frakturë instrumenti, transportim i kanalit.
- **Biologjike** — infeksion i vazhdueshëm, inflamacion periapikal.

Komplikacionet procedurale janë ngjarje të padëshiruara që ndodhin gjatë trajtimit endodontik si rezultat i kompleksitetit anatomik, kufizimeve teknike ose gabimeve operative. Incidenca e tyre rritet ndjeshëm në kanalet e ngushta, të kalcifikuara, me kurbatura të theksuara ose me variacione anatomike. Këto komplikacione mund të komprometojnë dezinfektimin, preparimin biomekanik dhe obturimin tridimensional të sistemit të kanaleve, duke ndikuar negativisht në prognozën afatgjatë të trajtimit.

Në praktikën bashkëkohore, shumica e komplikacioneve procedurale konsiderohen të parandalueshme përmes diagnostikimit të saktë, përdorimit të zmadhimit optik, krijimit të një glide path-i të sigurt, instrumentimit konservativ dhe respektimit të anatomisë origjinale të kanalit.

#	Komplikacioni procedural
1	Humbja e gjatësisë së punës
2	Humbja e patencës apikale
3	Bllokimi i kanalit
4	Formimi i ledge
5	Transportimi i kanalit
6	Formimi i zip dhe elbow
7	Perforimet
8	Fraktura e instrumenteve
9	Mbipërgatitja apikale (over-preparation)
10	Ekstruzioni i irrigantëve dhe materialit të obturimit

2.2 Humbja e gjatësisë së punës (Loss of Working Length)

Humbja e gjatësisë së punës është pamundësia për të ruajtur ose rifituar gjatësinë e punës së përcaktuar fillimisht gjatë instrumentimit të kanalit radikular. Konsiderohet një nga komplikacionet procedurale më të shpeshta, veçanërisht në kanalet e ngushta, të kalcifikuara ose me kurbatura të theksuara. Ruajtja e

një gjatësie pune të qëndrueshme është thelbësore për preparimin biomekanik efektiv, pasi siguron pastrimin dhe dezinfektimin e plotë të sistemit të kanaleve duke respektuar kufirin apikal.

Etiologjia

- Akumulimi i debris-it dentinar dhe mbetjeve pulpare në pjesën apikale, që shkakton bllokim të kanalit.
- Mungesa e rekapitulimit periodik me file të vogla (#08 ose #10).
- Humbja e patencës apikale.
- Formimi i një ledge në kanalet e lakuara.
- Devijimi ose transportimi i kanalit.
- Përdorimi i instrumenteve me taper të madh pa një glide path të sigurt.
- Kalcifikimet dhe anatomia komplekse e kanalit.



Pasoja klinike

- Preparim dhe dezinfektim jo i plotë i segmentit apikal, me persistencë të mikroorganizmave.
- Vështirësi në obturimin tridimensional dhe rritje e incidencës së periodontitit apikal persistent.
- Rrezik më i madh për formimin e ledge, transportim ose perforim gjatë përpjekjeve për të rifituar gjatësinë.

Parandalimi

- Krijimi i një glide path të riprodhueshëm para instrumentimit mekanik.
- Rekapitulimi pas çdo instrumenti me një file #08 ose #10 deri në gjatësinë e punës.
- Ruajtja e patencës apikale me kalim të lehtë të një file-i të vogël përtej konstrikcionit apikal.
- Irrigim i bollshëm me NaOCl dhe përdorim i EDTA për të reduktuar akumulimin e debris-it.
- Verifikimi periodik i gjatësisë së punës me apeks-lokator dhe radiografi kur nevojitet.

Menaxhimi

- Identifikimi i shkakut (bllokim, ledge, transportim ose kalcifikim).
- Irrigim intensiv me NaOCl dhe EDTA për të larguar debris-in.
- Përdorimi i fileve të vogla (#06, #08 ose #10), të parapërkulura nëse kanali është i lakuar.
- Lëvizje të buta watch-winding ose balanced force për të rifituar rrugën origjinale të kanalit.
- Rikrijimi i glide path-it dhe rikonfirmimi i gjatësisë së punës me apeks-lokator.

2.3 Humbja e patencës apikale (Loss of Apical Patency)

Patencia apikale përkufizohet si aftësia për të kaluar pasivisht një instrument manual me diametër të vogël (zakonisht file ISO #08 ose #10) përmes foramenit apikal, pa zgjeruar ose deformuar konstrikcionin apikal. Qëllimi i saj është të ruajë kalueshmërinë e segmentit apikal dhe të parandalojë grumbullimin e debris-it gjatë preparimit biomekanik. Humbja e patencës ndodh kur file-i nuk arrin më të kalojë në gjatësinë e punës, për shkak të bllokimit të kanalit ose ndryshimeve anatomike të krijuara gjatë instrumentimit.

Etiologjia

- Akumulimi i debris-it dentinar në segmentin apikal dhe mbetje të pulpës nekrotike ose vitale.
- Smear layer i kompaktuar.
- Instrumentim pa rekapitulim periodik dhe irrigim i pamjaftueshëm.
- Krijimi i një ledge ose transportimi apikal.

Në kanalet me kurbaturë të theksuar ose kalcifikime, rreziku për humbjen e patencës është dukshëm më i lartë.

Evidenca shkencore

Studimet kanë treguar se ruajtja e patencës apikale nuk rrit ndjeshëm incidencën e dhimbjes postoperative ose të ekstruzionit të debris-it kur kryhet në mënyrë korrekte. Përkundrazi, ajo ndihmon në ruajtjen e gjatësisë së punës dhe përmirëson cilësinë e preparimit biomekanik.

Menaxhimi

- 1. Irrigim intensiv me NaOCl.
- 2. Përdorimi i EDTA për të zbutur dhe larguar debris-in.
- 3. Futja graduale e një file #06 ose #08, shpesh e parapërkulur në kanalet e lakuara.
- 4. Lëvizje të buta watch-winding ose balanced force.
- 5. Pas rikthimit të patencës, rikrijimi i glide path-it dhe rivlerësimi i gjatësisë së punës.

2.4 Bllokimi i kanalit (Canal Blockage)

Bllokimi i kanalit është një komplikacion procedural që karakterizohet nga krijimi i një pengese mekanike brenda kanalit radikular, e cila pengon avancimin e instrumenteve deri në gjatësinë e punës së përcaktuar. Kjo pengesë formohet kryesisht nga grumbullimi dhe kompaktimi i debris-it dentinar, mbetjeve të indit pulpar, mikroorganizmave dhe smear layer-it në segmentin apikal ose në zona me ngushtime anatomike. Bllokimi i kanalit është një shkak kryesor i humbjes së gjatësisë së punës dhe i dështimit për të përfunduar preparimin biomekanik.



Faktorët anatomikë dhe proceduralë

- Anatomikë: kanale të ngushta, të kalcifikuara, me kurbatura të theksuara, të gjata dhe të holla, ose me variacione anatomike komplekse.
- Proceduralë: mungesa e rekapitulimit, humbja e patencës apikale, irrigim i pamjaftueshëm, dhe përdorimi i instrumenteve me taper të madh pa krijuar më parë glide path.

2.5 Formimi i ledge (Ledge Formation)

Ledge formation është krijimi i një devijimi artificial ose "shkalle" në murin e kanalit radikular, që ndryshon trajektoren natyrale të kanalit dhe pengon instrumentet të arrijnë gjatësinë e punës. Konsiderohet një nga komplikacionet procedurale më të zakonshme gjatë trajtimit të kanaleve të ngushta dhe me kurbatura të theksuara. Rezulton nga preparimi i gabuar biomekanik dhe shpesh është

pasojë e mungesës së një glide path-i të sigurt ose përdorimit të instrumenteve të ngurta që tentojnë të drejtojnë kurbaturën natyrale të kanalit.

Etiologjia

- **Faktorë anatomikë** — kurbatura të forta, kanale të ngushta ose të kalcifikuara, kurbatura të dyfishta (S-shaped), ndryshime të papritura në drejtimin e kanalit.
- **Faktorë proceduralë** — mungesa e glide path-it, përdorimi i fileve të mëdha para zgjerimit gradual, mosparapërkulja e fileve prej çeliku inox, humbja e gjatësisë së punës, presion i tepërt apikal, mungesa e rekapitulimit dhe irrigimit adekuat.

Instrumentet, veçanërisht ato prej çeliku inox, kanë tendencë të rikthehen në formën e tyre të drejtë. Kur përdoren në një kanal të lakuar, ushtrojnë presion mbi murin e jashtëm të kurbaturës dhe krijojnë një devijim artificial. Me instrumentime të përsëritura, ky devijim shndërrohet në një ledge, duke e bërë të pamundur ndjekjen e trajektorës origjinale të kanalit.




Figura 2.1 — Krahësimi skematik i tre gabimeve kryesore iatrogjene: ledge, perforim dhe transportim i kanalit, kundrejt trajektorës origjinale.

Parandalimi

- Krijimi i një glide path të sigurt dhe të riprodhueshëm.
- Përdorimi i fileve të vegjël (#08, #10, #15) përpara instrumentimit mekanik.
- Parapërkulja e fileve manualë në kanalet e lakuara.
- Instrumentim me file fleksibël NiTi dhe rekapitulim me ruajtje të patencës apikale.
- Irrigim i bollshëm, lubrifikim i kanalit dhe instrumentim pa forcë apikale.

Menaxhimi

1. Identifikimi i nivelit të devijimit.
2. Përdorimi i fileve shumë të vegjël (#06, #08 ose #10), të parapërkulur, për të kaluar përtej ledge-it.
3. Lëvizje të buta watch-winding ose balanced force për të rikrijuar trajektoren origjinale.

- 4. Pas rifitimit të gjatësisë së punës, rikrijimi i glide path-it dhe vazhdimi i preparimit me instrumente fleksibël.

Në rastet kur ledge nuk mund të tejkalohet, preparimi dhe obturimi kufizohen në nivelin e tij, gjë që mund të ndikojë negativisht në prognozën afatgjatë. Formimi i ledge shpesh paraprin komplikacione më serioze, si transportimi i kanalit, perforimi ose fraktura e instrumentit.

2.6 Transportimi i kanalit (Canal Transportation)

Transportimi i kanalit është një komplikacion procedural që karakterizohet nga devijimi i trajektores origjinale të kanalit radikular gjatë preparimit biomekanik, si rezultat i heqjes së pabarabartë të dentinës nga muret e kanalit. Sipas përkufizimit klasik të John I. Ingle, transportimi i kanalit është largimi i panevojshëm i dentinës nga muri i jashtëm i kurbaturës në pjesën apikale dhe nga muri i brendshëm në pjesën koronale, duke rezultuar në ndryshimin e formës dhe pozicionit të kanalit original.

Etiologjia

- **Faktorë anatomikë** — kurbatura të theksuara ($>25-30^\circ$), kanale me rreze të vogël kurbature, kanale të ngushta dhe të gjata, kurbatura të dyfishta, variacione anatomike komplekse.
- **Faktorë proceduralë** — mungesa e një glide path-i të sigurt, përdorimi i instrumenteve të ngurta në kanale të lakuara, instrumentim agresiv me file me taper të madh, presion i tepërt apikal, humbja e gjatësisë së punës.

Klasifikimi sipas vendndodhjes

Zona	Rëndësia klinike
E treta koronale	Zakonisht rëndësi më e vogël klinike
E treta e mesme	Mund të dobësojë strukturën e rrënjës
E treta apikale	Forma më serioze — komprometon pastrimin dhe obturimin e segmentit apikal

Transportimi duhet të dyshohet kur ndryshon papritur gjatësia e punës, apeks-lokatori jep vlera të paqëndrueshme, instrumenti nuk ndjek më trajektoren e zakonshme, ose radiografia tregon devijim nga boshti anatomik i rrënjës. Në raste komplekse, CBCT mund të ndihmojë në vlerësimin tridimensional të transportimit.



Menaxhimi sipas shkallës

- Transportim minimal: korrigjohet duke rikrijuar glide path-in dhe duke vazhduar preparimin me instrumente shumë fleksibël.
- Transportim i moderuar: kërkon preparim konservativ dhe obturim të kujdesshëm për të minimizuar boshllëqet.
- Transportim i rëndë ose me perforim: prognoza përkeqësohet dhe mund të nevojitet riparim me materiale biokeramike ose trajtim kirurgjikal endodontik.

Në studimet eksperimentale, transportimi i kanalit dhe aftësia qendruese e instrumenteve vlerësohen me analiza CBCT ose mikro-CT, duke përdorur indeksin e Gambill dhe raportin e qendrimit (centering ratio), të cilët lejojnë matjen objektive të ndryshimeve të shkaktuara nga preparimi biomekanik.

2.7 Formimi i Zip dhe Elbow

Kjo konsiderohet një formë e avancuar e transportimit apikal dhe ndodh kryesisht në kanalet me kurbaturë të theksuar. Zip është zgjerimi artificial, eliptik ose në formë loti i foramenit apikal, i shkaktuar nga heqja e tepërt e dentinës në murin e jashtëm të kurbaturës. Elbow është ngushtimi që formohet menjëherë koronal ndaj zip-it, duke krijuar një "qafë" të ngushtë që vështirëson instrumentimin dhe obturimin e segmentit apikal. Këto dy deformime zakonisht shfaqen së bashku dhe përfaqësojnë një dështim në ruajtjen e anatomisë origjinale të kanalit.

Etiologjia

- Kurbatura të theksuara të kanalit dhe përdorimi i instrumenteve të ngurta prej çeliku inox.
- Preparim agresiv me instrumente me taper të madh, mungesë e glide path-it, instrumentim përtej gjatësisë së punës, presion i tepërt apikal.

Për shkak të tendencës së instrumenteve për t'u drejtuar, hiqet më shumë dentinë nga muri i jashtëm i kurbaturës në zonën apikale — kjo e zhvendos foramenin apikal dhe krijon një hapje artificiale (zip). Njëkohësisht, menjëherë koronal ndaj saj mbetet një segment më i ngushtë (elbow), i cili pengon kalimin e instrumenteve dhe kondensimin efektiv të materialit të obturimit.




Figura 2.2 — Formimi i Zip dhe Elbow: zgjerimi artificial i foramenit apikal dhe ngushtimi menjëherë koronal ndaj tij.

Pasojat klinike dhe menaxhimi

- Humbje e konstrikcionit apikal dhe vështirësi në kontrollin e gjatësisë së punës.
- Mbyllje jo hermetike e apeksit dhe rrezik i shtuar për overfilling.
- Persistencë e mikroorganizmave në segmentin apikal dhe prognozë më e pafavorshme.

Nëse zip-i është minimal, mund të realizohet obturim me teknika termoplastike ose me materiale biokeramike për të përmirësuar adaptimin në zonën apikale. Në rastet e deformimeve të rënda, prognoza përkeqësohet dhe mund të kërkohej kirurgji endodontike ose, në raste të caktuara, ekstraksion. Parandalimi bazohet te krijimi i një glide path-i të sigurt, përdorimi i instrumenteve fleksibël NiTi, preparim konservativ dhe kontroll i shpeshtë i gjatësisë së punës.

2.8 Perforimet (Root Perforations)

Perforimi është një komplikacion procedural i karakterizuar nga krijimi i një komunikimi artificial midis sistemit të kanaleve radikulare dhe indeve përreth (ligamenti periodontal ose kocka alveolare), si pasojë e gabimeve gjatë krijimit të kavitetit të aksesit, instrumentimit biomekanik ose preparimit të hapësirës për post. Konsiderohet një nga komplikacionet më të rënda në endodonci, pasi mund të çojë në inflamacion periodontal, kontaminim bakterial, resorbim të kockës alveolare dhe, nëse nuk trajtohet në kohë, në humbjen e dhëmbit.

Lloji	Lokalizimi
Perforim koronal	Në nivelin e dhomës pulpare
Perforim furkal	Në dyshemenë e dhomës pulpare, më i shpeshtë te molarët
Perforim lateral	Në të tretën koronale, të mesme ose apikale të rrënjës
Perforim apikal	Në afërsi ose përtej foramenit apikal
Strip perforation	Perforim linear në murin e brendshëm të rrënjëve të holla

Lokalizimet kryesore të perforimeve radikulare




Figura 2.3 — Lokalizimet kryesore të perforimeve radikulare sipas klasifikimit anatomik.

Faktorët që ndikojnë në prognozë

- **1. Koha e trajtimit** — sa më shpejt të mbyllet perforimi, aq më e favorshme është prognoza, pasi reduktohet kontaminimi bakterial.
- **2. Lokalizimi** — perforimet apikale zakonisht kanë prognozë më të mirë se ato koronale ose furkale, të cilat janë më të ekspozuara ndaj kontaminimit oral.
- **3. Madhësia** — perforimet e vogla kanë prognozë më të mirë dhe janë më të lehta për t'u mbyllur hermetikisht.
- **4. Kontaminimi** — perforimet e kontaminuara me pështymë ose biofilm bakterial kanë prognozë më të pafavorshme.

Diagnostikimi bazohet në: gjakderdhje të papritur gjatë preparimit, dhimbje të menjëhershme (në dhëmbët vitalë), matje të papritura dhe të paqëndrueshme me apeks-lokator, radiografi periapikale me kënde të ndryshme, dhe CBCT në rastet e dyshimta ose komplekse.



Menaxhimi

- Diagnostikimi i menjëhershëm dhe kontrolli i gjakderdhjes.
- Izolimi me diga gome dhe dezinfektimi i zonës pa zgjeruar më tej perforimin.
- Mbyllja hermetike me materiale biokeramike — kryesisht MTA (Mineral Trioxide Aggregate) ose materiale moderne me bazë silikati kalciumi (Biodentine dhe biokeramika të ngjashme), të cilat ofrojnë biokompatibilitet të lartë, aftësi vulosëse, bioaktivitet dhe stimulim të formimit të çimentos e kockës.

Perforimet përfaqësojnë një nga komplikacionet proceduriale me ndikimin më të madh në prognozën e trajtimit endodontik. Zhvillimi i materialeve biokeramike dhe përdorimi rutinë i mikroskopit operativ kanë rritur ndjeshëm shkallën e suksesit në riparimin e tyre — suksesi varet kryesisht nga diagnostikimi i hershëm, kontrolli i kontaminimit bakterial dhe mbyllja hermetike.

2.9 Fraktura e instrumenteve (Instrument Separation)

Fraktura e instrumenteve konsiston në ndarjen ose thyerjen e një instrumenti endodontik brenda sistemit të kanaleve radikulare gjatë preparimit biomekanik ose ritrajtimit. Fragmenti i mbetur mund të pengojë aksesin në segmentin apikal, duke kufizuar pastrimin, dezinfektimin dhe obturimin adekuat. Megjithatë fraktura e instrumentit nuk shkakton dështim të menjëhershëm të trajtimit, mund të ndikojë negativisht në prognozë, veçanërisht kur ndodh para përfundimit të dezinfektimit të kanalit.

Incidenca e frakturës në literaturë varion nga 0.5% deri në 5%, në varësi të llojit të instrumentit, kompleksitetit anatomik dhe teknikës së instrumentimit. Instrumentet NiTi kanë incidencë më të lartë të frakturës krahasuar me ato prej çeliku inox, për shkak të mekanizmave specifike të dështimit.

Mekanizmat e frakturës

- **1. Lodhja ciklike** — ndodh kur instrumenti rrotullohet vazhdimisht në një kanal të lakuar, duke iu nënshtruar cikleve të përsëritura kompresioni/tensioni. Formohen mikroçarje që bashkohen dhe çojnë në frakturë pa deformim të dukshëm paraprak. Favorizohet nga kurbatura të mëdha, kanale në formë S, përdorim i zgjatur i të njëjtit instrument dhe shpejtësi të larta rrotullimi.

- **2. Stresi torsional** — ndodh kur maja e instrumentit bllokohet brenda kanalit ndërsa pjesa koronale vazhdon të rrotullohet. Favorizohet nga kanale të ngushta ose të kalcifikuara, mungesa e glide path-it dhe presioni i tepërt apikal.

Diagnostikimi dhe menaxhimi

Diagnostikimi bazohet në humbjen e papritur të rezistencës së instrumentit, inspektimin e instrumentit pas nxjerrjes, radiografi periapikale, dhe CBCT kur nevojitet vlerësim tridimensional i pozicionit të fragmentit. Vendimmarrja varet nga pozicioni dhe gjatësia e fragmentit, shkalla e infeksionit të kanalit, anatomia e rrënjës dhe përvoja e operatorit.

- **1. Bypass** — kalimi pranë fragmentit me file të vegjël (#06, #08, #10), duke krijuar një rrugë të re drejt apeksit. Opsioni më konservativ.
- **2. Heqja e fragmentit** — me ultratinguj nën mikroskop operativ ose sisteme të dedikuara. Duhet kryer vetëm kur përfitimi biologjik tejkalon rrezikun e dobësimit të rrënjës ose perforimit.
- **3. Lënia e fragmentit in situ** — nëse heqja ose bypass-i nuk janë të realizueshme pa rrezik të madh, trajtimi përfundon deri në nivelin e fragmentit, me informim dhe ndjekje periodike klinike/radiografike të pacientit.

Faktori më i rëndësishëm prognostik

Fraktura e instrumentit nuk përbën domosdoshmërisht dështim të trajtimit endodontik. Faktori më i rëndësishëm prognostik është nëse sistemi i kanaleve është dezinfektuar në mënyrë adekuate përpara frakturës. Në rastet ku infeksioni nuk është eliminuar dhe fragmenti pengon instrumentimin e segmentit apikal, prognoza është më pak e favorshme.

2.10 Mbipërgatitja apikale (Apical Over-preparation)

Mbipërgatitja apikale karakterizohet nga zgjerimi i tepërt i segmentit apikal të kanalit radikular përtej kufijve biologjikë të konstrikcionit apikal. Si pasojë, humbet anatomia natyrale e apeksit dhe dëmtohen indet periapikale. Objektivi i preparimit biomekanik është ruajtja e konstrikcionit apikal si barrierë natyrale për irrigimin dhe obturimin — kur kjo strukturë dëmtohet, rritet rreziku i ekstruzionit të irrigantëve, debris-it dhe materialeve të obturimit në indet periapikale.



Pasojat biologjike

- Dëmtim mekanik i ligamentit periodontal dhe inflamacion i indeve periapikale.
- Ekstruzion i debris-it dentinar dhe mikroorganizmave, me rritje të incidencës së dhimbjes postoperatore (flare-up).
- Humbje e konstrikcionit apikal dhe rrezik i shtuar për overfilling dhe overextension.

Diagnoza bazohet në matje të përsëritura me apeks-lokator, radiografi periapikale, ndryshim të papritur të gjatësisë së punës, dhe ndjeshmëri ose gjakderdhje në zonën apikale gjatë instrumentimit. Menaxhimi përfshin ndërprerjen e instrumentimit përtej apeksit, rivlerësimin e gjatësisë së punës, irrigim të kujdesshëm, dhe — në rastet me humbje të konsiderueshme të konstrikcionit apikal — krijimin e një apical barrier me materiale biokeramike si MTA.

2.11 Ekstruzioni i hipoklorit të natriumit (Sodium Hypochlorite Accident)

Ekstruzioni aksidental i hipoklorit të natriumit (NaOCl accident) është një komplikacion procedural që ndodh kur solucion i rruges kalon përtej foramenit apikal ose përmes një perforimi, duke depërtuar në indet periapikale. Për shkak të vetive të tij citotoksike dhe proteolitike, hipokloriti shkakton dëmtim akut të indeve të buta, inflamacion të rëndë dhe nekrozë qelizore. Megjithëse NaOCl mbetet irriganti më efektiv në endodonci, përdorimi i tij kërkon kontroll rigoroz për të shmangur komplikacionet.

Etiologjia dhe patofiziologjia

- Futja e gjilpërës shumë afër apeksit ose bllokimi i majës së gjilpërës në kanal (binding).
- Aplikimi i presionit të lartë gjatë irrigimit.
- Mbipërgatitja apikale, apeksi i hapur (immature apex), resorbimi apikal, ose perforimet radikulare.

Hipokloriti i natriumit ka pH të lartë (rreth 11–12) dhe veprim të fuqishëm oksidues. Kur ekstrudohet në indet periapikale, shkakton lizë të membranave qelizore, denaturim të proteinave, hemolizë, dëmtim të enëve të gjakut, nekrozë të indeve të buta dhe inflamacion akut. Shkalla e dëmtimit varet nga përqendrimi i NaOCl, sasia e ekstruduar dhe lokalizimi anatomik.



Shenjat dhe simptomat

- Dhimbje shumë e fortë dhe e menjëhershme gjatë irrigimit, me gjakderdhje nga kanali.
- Ënjtje e shpejtë e indeve përreth, ekimozë (hematomë) në orët/ditët në vijim, dhe kufizim i hapjes së gojës (trismus) veçanërisht në molarët mandibularë.
- Në raste të rënda: parestezi, infeksion sekondar, ose nekrozë e indeve të buta.

Menaxhimi

- **Menjëherë pas aksidentit** — ndërpritet irrigimi, qetësohet pacienti, kanali irrigohet me solucion fiziologjik për të holluar mbetjet e NaOCl, dhe vendoset kompresë e ftohtë gjatë 6–24 orëve të para.
- **Në fazën pasuese** — kompresë të ngrohta pas 24 orësh për të favorizuar resorbimin e hematomës; analgjëzikë dhe antiinflamatorë sipas nevojës; antibiotikët vetëm kur ka shenja infeksioni sekondar; kortikosteroidet mund të konsiderohen në edemë të rëndë.

Parandalimi

- Përcaktimi i saktë i gjatësisë së punës.
- Përdorimi i gjilpërave me dalje anësore (side-vented needles).
- Mosfutja e gjilpërës më afër se 1–2 mm nga gjatësia e punës.
- Irrigim i ngadaltë dhe pa presion, duke siguruar që gjilpëra të lëvizë lirshëm brenda kanalit.

Shumica e pacientëve shërohen plotësisht me trajtim konservativ. Megjithatë, në rastet me ekstruzion të madh ose dëmtim të strukturave anatomike fqinje, mund të mbeten komplikacione afatgjata si fibrozë, parestezi ose defekte të indeve të buta.

Komplikacionet proceduriale gjatë trajtimit të kanaleve të vështira përfaqësojnë një sfidë të rëndësishme në praktikën endodontike. Ato janë rezultat i ndërveprimit midis kompleksitetit anatomik të sistemit të kanaleve radikulare dhe faktorëve teknikë që lidhen me instrumentimin, irrigimin dhe obturimin.

Megjithatë, shumica e këtyre komplikacioneve janë të parandalueshme: diagnostikimi i kujdesshëm paraoperator, krijimi i një glide path të riprodhueshëm, ruajtja e patencës apikale, përdorimi i instrumenteve fleksibël NiTi, irrigimi efektiv dhe kontrolli i vazhdueshëm i gjatësisë së punës janë elementë thelbësorë për reduktimin e rrezikut.

Pikat kyçe

- Shumica e komplikacioneve procedurale (ledge, transportim, humbje e patencës) fillojnë nga i njëjti shkak rrënjësor: mungesa e një glide path-i të sigurt.
- Rekapitulimi periodik dhe ruajtja e patencës apikale janë masat më efektive dhe më ekonomike të parandalimit, të zbatueshme në çdo rast.
- Prognoza e frakturës së instrumentit dhe e perforimeve varet më shumë nga koha dhe cilësia e dezinfektimit të kryer përpara komplikacionit sesa nga vetë ngjarja.
- Ekstruzioni i NaOCl kërkon njohje të shpejtë të shenjave klinike dhe reagim të qetë e sistematik, jo panik — shumica e rasteve shërohen plotësisht me menaxhim konservativ.

TEMA 3. RETRAJTIMI ENDODONTIK

Retrajtimi endodontik (endodontic retreatment) është procedura e ndërmarrë kur një trajtim i mëparshëm endodontik nuk ka arritur ose ka humbur shërimin periapikal, ose kur simptomat e vazhdueshme apo lezionet e reja tregojnë dështim të trajtimit fillestar. Ai përfaqëson një nga procedurat më komplekse në endodonci, pasi kombinon sfidat e trajtimit fillestar me vështirësi shtesë të lidhura me materialet e vjetra, anatomi të ndryshuara nga instrumentimi i mëparshëm, dhe shpesh me komplikacione të pazgjidhura nga trajtimi i parë.

3.1 Përkufizimi dhe indikacionet

Retrajtimi indikohet kur ekziston evidencë klinike ose radiografike e dështimit të trajtimit fillestar, ose kur kanali duhet rihapur për arsye restauruese ose diagnostike:

- Lezion periapikal i ri ose i rritur në një dhëmb të trajtuar më parë.
- Simptoma të vazhdueshme (dhimbje, ndjeshmëri në perkusion) pas një trajtimi të kryer.
- Obturim i dukshëm i pamjaftueshëm (i shkurtër, jo homogjen, ose me kanale të papërfshira).
- Nevojë për rihapje të kanalit për qëllime restauruese (p.sh. preparim posti) kur ka dyshim për infeksion rezidual.
- Zbulim i një kanali të patrajtuar (p.sh. MB2 i pagjetur) në një dhëmb tashmë të obturuar.

3.2 Shkaqet e dështimit të trajtimit fillestar

Dështimi i trajtimit endodontik është pothuajse gjithmonë rezultat i një infeksioni bakterial rezidual ose rihyrës brenda sistemit të kanaleve, i lidhur me një ose më shumë nga faktorët e mëposhtëm:

- **Faktorë intrakanalarë** — kanale të papastruara ose të pagjetura (MB2, kanale aksesore), dezinfektim jo i plotë, mbetje biofilmi rezistent (p.sh. *Enterococcus faecalis*), obturim jo hermetik me boshllëqe.
- **Faktorë ekstraradikularë** — infeksion i vendosur jashtë sistemit të kanaleve (biofilm periapikal, cist të vërteta radikulare), reagim i trupit të huaj ndaj materialit të ekstruduar.
- **Faktorë koronarë** — mikroinfiltrim koronal për shkak të një restaurimi të pamjaftueshëm ose të vonuar, që rihap rrugën e reinfeksionit të sistemit të kanaleve tashmë të dezinfektuar.
- **Faktorë proceduralë** — komplikacione të patrajuara nga seanca fillestare (ledge, transportim, perforim, instrument i frakturuar) që kanë kufizuar dezinfektimin origjinal.

3.3 Vlerësimi paraprak dhe vendimmarrja

Përpara fillimit të retrajtimit, duhet kryer një vlerësim i plotë për të përcaktuar nëse rasti është i përshtatshëm për retrajtim jo-kirurgjik, kërkon kirurgji endodontike, apo — në raste të pafavorshme — ekstraksion.

Opsioni	Kur indikohet
Retrajtim jo-kirurgjik	Kanal i aksesueshëm; shkak i dështimit brenda sistemit të kanaleve; restaurim koronal i riparueshëm
Kirurgji endodontike (apikoektomi)	Infeksion ekstraradikular i dyshuar; kanal i paaksesueshëm (post i cementuar fort, perno); dështim i një retrajtimit të mëparshëm
Ekstraksion	Frakturë vertikale e rrënjës; strukturë e mbetur e pamjaftueshme; rrënjë e paridukshme për riparim

Vendimmarrja në rastet e dështimit të trajtimit endodontik



Figura 3.1 — Skema e vendimmarrjes në rastet e dështimit të trajtimit endodontik.

Vlerësimi paraprak

Vlerësimi duhet të përfshijë gjithmonë radiografi periapikale me disa kënde dhe, kur rasti e kërkon, CBCT për të identifikuar kanale të papërpunuara, perforime, resorbime, ose çarje radikulare të padukshme në radiografinë konvencionale.

3.4 Protokoli klinik i retrajtimit jo-kirurgjik

Retrajtimi ndjek një sekuencë të strukturuar, e cila zakonisht kërkon më shumë kohë dhe kujdes se një trajtim fillestar:

- **1. Heqja e restaurimit koronal** — dhe vlerësimi i strukturës dentare të mbetur dhe i mundësisë për restaurim final.
- **2. Heqja e materialit të vjetër të obturimit** — me kombinim solventësh (p.sh. kloroformi ose eukaliptol në sasi të kontrolluar), instrumente rrotulluese të dedikuara për heqje gutaperke, dhe instrumente ultrasonike nën mikroskop.
- **3. Ri-negocimi dhe eksplorimi i plotë** — kërkim sistematik i kanaleve të papërpunuara ose të pagjetura, veçanërisht në zonat me prevalencë të njohur të lartë (MB2, kanale të dyfishta).
- **4. Ri-instrumentimi biomekanik** — me respektim të plotë të parimeve të glide path-it dhe patencës apikale, duke qenë veçanërisht të kujdesshëm pasi anatomia origjinale mund të jetë tashmë e ndryshuar nga trajtimi i parë.

- **5. Dezinfektim i zgjatur** — protokoll irrigimi më intensiv, shpesh me medikacion intrakanalar ndërmjet seancave (Ca(OH)_2) kur infeksioni është i vazhdueshëm.
- **6. Ri-obturimi dhe restaurimi final** — sipas të njëjtave parime si trajtimi fillestar, me theks të veçantë të vulosja koronale e menjëhershme.

3.5 Sfidat specifike të retrajtimit

- **Poste të cementuara** — heqja e posteve metalike ose me fibra kërkon instrumente të dedikuara (ultrasonik, sisteme heqje posti) dhe rrit rrezikun e frakturës radikulare nëse nuk kryhet me kujdes.
- **Instrumente të fraktuara nga trajtimi i parë** — menaxhohen sipas të njëjtave parime të përshkruara në Temën 2 (bypass, heqje, ose lënie in situ, në varësi të rrezik-përfitimit).
- **Materiale rezistente ose sealerë biokeramikë** — disa sealerë modernë janë veçanërisht të vështirë për t'u hequr plotësisht nga muret dentinare, çka mund të kufizojë ri-dezinfektimin.
- **Kalcifikime dytësore** — shpesh të pranishme si përgjigje biologjike ndaj trajtimit të parë, duke e bërë ri-negocimin më të vështirë se negocimi fillestar.

3.6 Prognoza e retrajtimit

Prognoza e retrajtimit endodontik jo-kirurgjik varet nga një kombinim faktorësh: prania ose mungesa e lezionit periapikal para retrajtimit, madhësia e lezionit, cilësia e arritshme e ri-obturimit, dhe cilësia e restaurimit final koronal. Në përgjithësi, dhëmbët pa lezion periapikal paraprak kanë prognozë më të favorshme se ata me lezion të pranishëm, dhe retrajtimet e kryera me mbështetje të mikroskopit operativ dhe protokolleve moderne të irrigimit tregojnë shkallë suksesi ndjeshëm më të lartë krahasuar me qasjet tradicionale.

Pikat kyçe

- Retrajtimi indikohet kur ka evidencë klinike/radiografike të dështimit, ose kur nevojitet rihapje për qëllime restauruese apo diagnostike.
- Vendimi ndërmjet retrajtimit jo-kirurgjik, kirurgjisë endodontike, dhe ekstraksionit duhet bazuar në një vlerësim sistematik të aksesueshmërisë, shkakut të dështimit dhe strukturës së mbetur.
- Suksesi i retrajtimit varet kryesisht nga heqja e plotë e materialit të vjetër, ri-negocimi i të gjitha kanaleve, dhe dezinfektimi i zgjatur — jo thjesht nga zëvendësimi i materialit të obturimit.

TEMA 4. IRRIGIMI DHE DEZINFEKTIMI I AVANCUAR I SISTEMIT TË KANALEVE

Preparimi biomekanik, pavarësisht sistemit të instrumenteve të përdorura, nuk mund të pastrojë më shumë se 50–60% të sipërfaqes totale të murit të kanalit në anatomi komplekse. Dezinfektimi i plotë i sistemit të kanaleve radikulare varet kryesisht nga irrigimi kimik — jo nga vetë instrumentimi mekanik. Ky tema thellohet në parimet, irriguesit dhe protokollet e avancuara që përcaktojnë dezinfektimin efektiv të kanaleve të vështira.

4.1 Qëllimet biologjike të irrigimit

Irrigimi endodontik synon njëkohësisht disa objektiva biologjikë dhe mekanikë:

- Eliminimi i mikroorganizmave dhe biofilmit bakterial rezistent.
- Tretja e indeve organike (pulpë e mbetur, biofilm).
- Largimi i debris-it dentinar dhe i smear layer-it të krijuar gjatë instrumentimit.
- Lubrifikimi i kanalit gjatë preparimit mekanik.
- Penetrimi në zona anatomikisht të paarritshme nga instrumentet (isthmuse, kanale laterale, delta apikale).

4.2 Hipokloriti i natriumit (NaOCl)

Hipokloriti i natriumit mbetet irriguesi kryesor dhe më i studiuar në endodonci, falë aftësisë unike për të tretur inde organike dhe për të eliminuar një spektër të gjerë mikroorganizmash, përfshirë biofilmin. Përqendrimet e përdorura klinikisht variojnë zakonisht nga 0.5% deri në 5.25% — përqendrimet më të larta rrisin efikasitetin antibakterial dhe tretës, por rrisin edhe citotoksicitetin në rast ekstruzioni aksidental (shih Temën 2, seksioni 2.11).

Faktorët që rrisin efikasitetin e NaOCl

Vëllimi total i irrigantit të përdorur gjatë seancës, koha e kontaktit me muret e kanalit, ngrohja e lehtë e solucionit, dhe aktivizimi mekanik (ultrasonik ose sonik) ndikojnë të gjithë në efikasitetin real klinik të NaOCl — jo vetëm përqendrimi i tij.

4.3 EDTA dhe heqja e smear layer-it

EDTA (Ethylenediaminetetraacetic acid), zakonisht në përqendrim 17%, është agjenti kelues standard për heqjen e përbërësit inorganik të smear layer-it, i krijuar gjatë instrumentimit mekanik nga bashkimi i debris-it dentinar me mbetjet organike. Përdoret tipikisht si irrigim final, pas NaOCl, për disa minuta, duke lejuar hapjen e tubulave dentinare dhe përmirësimin e depërtimit të mëvonshëm të sealer-it.

Kujdes klinik

- NaOCl dhe EDTA nuk duhet përzier drejtpërdrejt në kanal — reagimi ndërmjet tyre neutralizon aftësinë tretëse të hipokloritit. Rekomandohet një shpëlarje me solucion fiziologjik ndërmjet dy irriguesve, ose ndjekja e sekuencës së rekomanduar (NaOCl gjatë instrumentimit → EDTA si hap final → shpëlarje finale me NaOCl për disa sekonda).

4.4 Klorheksidina dhe protokollet alternative

Klorheksidina (CHX), zakonisht në përqendrim 2%, përdoret kryesisht si irrigues plotësues në ritrajtime ose në pacientë me alergji të dokumentuar ndaj hipokloritit. Ka veti antibakteriale të mira dhe substantivitet (efekt antimikrobial i zgjatur pas aplikimit), por, ndryshe nga NaOCl, nuk tret inde organike — çka e bën të papërshtatshme si irrigues i vetëm.

Kujdes: reaksioni CHX–NaOCl

Përzierja e klorheksidinës me hipokloritin e mbetur në kanal formon një precipitat kaf-portokalli (parachloroaniline, PCA), i cili mund të obturojë tubulat dentinare dhe ka ngritur shqetësime për toksicitet. Për këtë arsye, midis NaOCl dhe CHX duhet gjithmonë një shpëlarje intermediare me solucion fiziologjik ose alkool.

4.5 Sekuenca dhe protokoli final i irrigimit

Një protokoll tipik, i bazuar në evidencë, për kanalet e vështira ndjek sekuencën e mëposhtme:

- 1. Irrigim me NaOCl gjatë gjithë fazës së instrumentimit biomekanik, me rifreskim të vazhdueshëm të solucionit.
- 2. Irrigim final me EDTA 17% për 1–3 minuta, për heqjen e smear layer-it.
- 3. Shpëlarje me solucion fiziologjik për të neutralizuar mbetjet e EDTA.
- 4. Shpëlarje finale me NaOCl për disa sekonda, për të rivendosur aktivitetin antibakterial përpara obturimit.
- 5. Tharje e kanalit me kono letre sterile përpara obturimit.



Figura 4.1 — Sekuenca finale e irrigimit endodontik, hap pas hapi.

4.6 Aktivizimi i irrigantëve

Siç u trajtua në detaje në Temën 1 (seksioni 1.6), irrigimi pasiv me shiringë ka penetrim të kufizuar në isthmuse, kanale laterale dhe delta apikale. Aktivizimi i irrigantëve — kryesisht përmes Passive Ultrasonic

Irrigation (PUI), por edhe përmes sistemeve sonike ose lazerike — rrit ndjeshëm depërtimin dhe efikasitetin antibakterial të NaOCl dhe EDTA, dhe konsiderohet sot pjesë standarde e protokollit të dezinfektimit në kanalet e klasifikuara si të vështira.



Pikat kyçe

- Dezinfektimi i sistemit të kanaleve varet kryesisht nga irigimi kimik, jo vetëm nga instrumentimi mekanik — asnjë sistem instrumentesh, sado modern, nuk e zëvendëson këtë parim.
- NaOCl mbetet irriguesi kryesor për vetitë e tij tretëse dhe antibakteriale; EDTA plotëson protokollin duke hequr smear layer-in.
- NaOCl dhe klorheksidina nuk duhet përzier kurrë drejtpërdrejt — kërkohet gjithmonë një shpëlarje intermediare.
- Aktivizimi (veçanërisht ultrasonik) i irigantëve rrit ndjeshëm efikasitetin e dezinfektimit në anatomi komplekse dhe duhet konsideruar standard në kanalet e vështira.

TEMA 5. VLERËSIMI I REZULTATIT DHE SUKSESI AFATGJATË I TRAJTIMIT ENDODONTIK

Cikli i plotë i kujdesit endodontik nuk përfundon me obturimin e kanalit apo restaurimin final — ai kërkon një vlerësim sistematik afatgjatë për të konfirmuar shërimin biologjik dhe për të identifikuar në kohë çdo shenjë dështimi. Ky tema përmbledh kriteret, faktorët prognostikë dhe protokollet e ndjekjes që përcaktojnë suksesin e vërtetë klinik të një trajtimi endodontik.

5.1 Kriteret e suksesit dhe dështimit

Suksesi i trajtimit endodontik vlerësohet zakonisht në tre nivele: klinik, radiografik dhe funksional. Një dhëmb konsiderohet i shëruar kur nuk ka simptoma klinike (dhimbje, ndjeshmëri në perkusion, fistulë), radiografia tregon një hapësirë normale të ligamentit periodontal ose reduktim/zhdukje të lezionit periapikal paraekzistues, dhe dhëmbi mbetet funksional brenda arkadës.

Kategoria	Kriteret
I shëruar (healed)	Asimptomatik; radiografikisht normal ose me hapësirë ligamenti të pandryshuar
Në shërim (healing)	Asimptomatik; lezioni periapikal në reduktim progresiv krahasuar me kontrollet e mëparshme
I pashëruar / dështim	Simptoma të vazhdueshme ose lezion i ri/i zmadhuar; nevojitet rivlerësim i planit të trajtimit
Dallimi klinik–radiografik Mungesa e simptomave klinike nuk garanton shërim të plotë radiografik, dhe anasjelltas — një lezion i vogël rezidual mund të mbetet radiografikisht i dukshëm për muaj apo vite pavarësisht një procesi shërimi biologjikisht aktiv. Për këtë arsye, vlerësimi i rezultatit duhet të kombinojë gjithmonë të dyja perspektivat, të mbështetura nga koha e mjaftueshme e ndjekjes.	

5.2 Faktorët prognostikë

Proгноza e trajtimit endodontik ndikohet nga faktorë të pranishëm në tre faza kryesore:

- **Faktorë paraoperativë** — prania dhe madhësia e lezionit periapikal paraekzistues, gjendja e pulpës (vitale kundrejt nekrotike), dhe prania e simptomave paraprake. Dhëmbët pa lezion periapikal para trajtimit kanë prognozë ndjeshëm më të favorshme.
- **Faktorë intraoperativë** — cilësia e dezinfektimit dhe e preparimit biomekanik, prania ose mungesa e komplikacioneve procedurale (shih Temën 2), dhe cilësia e obturimit tridimensional.
- **Faktorë postoperativë** — cilësia dhe koha e restaurimit koronal final. Një restaurim i vonuar ose me vulosje jo hermetike mbetet një nga shkaqet kryesore të dështimit afatgjatë, pavarësisht cilësisë së vetë trajtimit endodontik.



Faktori më i rëndësishëm i vetëm

- Në literaturën endodontike, prania e infeksionit (nekrozë pulpore ose pa lezion periapikal) para trajtimit mbetet faktori i vetëm më i fortë prognostik — dhëmbët e trajtuar për pulpë vitale, pa infeksion paraprak, kanë shkallë suksesi dukshëm më të lartë se ata të trajtuar për nekrozë të infektuar me lezion periapikal të pranishëm.

5.3 Radiografia e ndjekjes dhe koha e vlerësimit

Ndjekja radiografike e një dhëmbi të trajtuar endodontikisht ndjek zakonisht një kalendar të shkallëzuar, i cili lejon kohën e mjaftueshme biologjike për shërimin e kockës periapikale:

- Kontroll fillestar: 6 muaj pas trajtimit.
- Kontroll i dytë: 12 muaj pas trajtimit.
- Kontroll përfundimtar: 24 muaj, ose më gjatë (deri në 4 vjet) në rastet me lezione fillestare të mëdha ose komplekse.



Figura 5.1 — Kalendari i ndjekjes radiografike pas trajtimit endodontik.

Nëse në kontrollin e 24 muajve lezioni ka reduktuar madhësinë në mënyrë progresive por nuk është zhdukur plotësisht, mund të rekomandohet një periudhë shtesë ndjekjeje përpara se të konsiderohet dështim, pasi shërimi i plotë i kockës mund të kërkojë deri në disa vite në raste të lezioneve fillestare të mëdha.

5.4 Shërimi periapikal — dinamika kohore

Shërimi i indeve periapikale pas një trajtimi endodontik të suksesshëm ndjek një sekuencë biologjike të parashikueshme: reduktimi i inflamacionit akut ndodh brenda javëve të para, ndjekur nga rigjenerimi progresiv i trabekulave kockore dhe rikthimi i vazhdimësisë normale të ligamentit periodontal përgjatë

muajve në vijim. Shpejtësia e këtij procesi ndikohet nga madhësia fillestare e lezionit, mosha e pacientit, dhe prania e faktorëve sistemikë që ndikojnë në shërimin e kockës (p.sh. diabeti i pakontrolluar).

5.5 Kur konsiderohet dështim afatgjatë

Një trajtim konsiderohet i dështuar afatgjatë kur, në kontrollet e planifikuara, vërehet një ose më shumë nga sa vijon:

- Shfaqja e një lezioni të ri periapikal aty ku nuk kishte më parë.
- Rritja e madhësisë së një lezioni ekzistues, në vend të reduktimit progresiv.
- Shfaqja ose vazhdimi i simptomave klinike (dhimbje, fistulë, ndjeshmëri).
- Zbulimi i një komplikacioni të ri (p.sh. frakturë vertikale) që komprometon prognozën afatgjatë të dhëmbit.

Në secilin nga këto raste, mjeku duhet të rivlerësojë shkakun e mundshëm — infeksion rezidual intrakanalar, mikroinfiltrim koronal, infeksion ekstraradikular, ose frakturë — dhe të diskutojë me pacientin opsionet: retrajtim jo-kirurgjik, kirurgji endodontike, ose ekstraksion, sipas parimeve të paraqitura në Temën 3.



Pikat kyçe

- Vlerësimi i rezultatit kërkon kombinimin e kriterëve klinike dhe radiografike, të mbështetura nga një kalendar ndjekjeje 6–24+ muaj.
- Infeksioni (nekroza pulpare me lezion periapikal) para trajtimit mbetet faktori i vetëm më i fortë prognostik i njohur në endodonci.
- Shërimi periapikal është një proces biologjik gradual — një lezion rezidual i vogël në kontrollin e 12 muajve nuk përbën domosdoshmërisht dështim nëse tregon reduktim progresiv.
- Restaurimi koronal me vulosje të mirë mbetet po aq i rëndësishëm sa vetë trajtimi endodontik për suksesin afatgjatë.

REFERENCA

1. American Association of Endodontists. *Clinical guidelines on root canal preparation*.
2. Bergenholtz G, Hørsted-Bindslev P, Reit C. *Textbook of Endodontology*. 3rd ed. Wiley-Blackwell; 2020.
3. Berutti E, Cantatore G, Castellucci A, et al. *Use of nickel-titanium rotary PathFile to create the glide path*.
4. Boutsoukis C, Arias A. *Irrigation activation techniques in endodontics*.
5. Buchanan LS. *The standardized glide path technique*.
6. Ferrari M, Sorrentino R. *Fiber posts and restoration of root-filled teeth*.
7. Gulabivala K, Ng YL. *Factors that affect the outcomes of root canal treatment and retreatment*. Int Endod J. 2023;56(Suppl 2):82-115.
8. Hargreaves KM, Berman LH. *Cohen's Pathways of the Pulp*. 12th ed. Elsevier; 2021.
9. Hülsmann M, Rödig T, Nordmeyer S. *Complications during root canal irrigation*.
10. Ingle JI, Bakland LK, Baumgartner JC. *Ingle's Endodontics*. 7th ed. BC Decker; 2019.
11. Mannocci F, Ferrari M. *Restoration of endodontically treated teeth*.
12. Mohammadi Z, Dummer PMH. *Properties and applications of calcium hydroxide in endodontics*.
13. Ng YL, Mann V, Gulabivala K. *Outcome of primary root canal treatment*.
14. Peters OA. *Current challenges and concepts in the preparation of root canal systems: a review*. J Endod. 2004;30:559-567.
15. Plotino G, Gambarini G, Grande NM, et al. *Current concepts in nickel-titanium instruments*.
16. Ruddle CJ. *Cleaning and shaping the root canal system*.
17. Schäfer E, Bürklein S. *Impact of glide path on shaping ability of NiTi instruments*.
18. Schilder H. *Cleaning and shaping the root canal system*.
19. Schilder H. *Filling root canals in three dimensions*. Dent Clin North Am. 1967;11:723-744.
20. Siqueira JF Jr. *Microbiology of apical periodontitis*.
21. Siqueira JF Jr, Lopes HP. *Mechanisms of antimicrobial activity of calcium hydroxide*.
22. Torabinejad M, Fouad AF, Shabahang S. *Endodontics: Principles and Practice*. 7th ed. Elsevier; 2024.
23. van der Sluis LWM, Versluis M, Wu MK, Wesselink PR. *Passive ultrasonic irrigation*.

24. Versiani MA, Basrani B, Sousa-Neto MD. *The Root Canal Anatomy in Permanent Dentition*. Springer; 2019.
25. Vertucci FJ. *Root canal anatomy of the human permanent teeth*. Oral Surg Oral Med Oral Pathol. 1984;58:589-599.
26. Whitworth J. *Methods of root canal obturation*.
27. Wu MK, Wesselink PR. *Quality of root fillings and apical leakage*.
28. Zehnder M. *Root canal irrigants*. J Endod. 2006;32:389-398.

MODULI II • ENDODONCI KLINIKE E AVANCUAR

TRAJTIMI ENDODONTIK I KANALEVE TË VËSHTIRA

Instrumentimi, teknologjitë moderne, retrajtimi dhe menaxhimi i komplikacioneve në trajtimin e kanaleve të vështira

Lektore: Borana Vrapi

Material edukativ për zhvillim profesional të vazhduar

ÇFARË DO TË MBULOJMË

Pesë tema, nga instrumentimi deri te vlerësimi i rezultatit afatgjatë

1

Instrumentimi dhe teknologjitë moderne

Instrumente manuale, NiTi, apex locator, mikroskop, ultrasonik, digjital

2

Komplikacionet dhe menaxhimi i tyre

10 komplikacionet kryesore proceduriale dhe strategjitë e menaxhimit

3

Retrajtimi endodontik

Indikacionet, vendimmarrja, protokoli klinik dhe prognoza

4

Irrigimi dhe dezinfektimi i avancuar

NaOCl, EDTA, klorheksidina dhe protokoli final i irrigit

5

Vlerësimi i rezultatit dhe suksemi afatgjatë

Kriteret e suksesit, faktorët prognostikë, ndjekja radiografike

PSE JANË TË RËNDËSISHME KËTO TEMA

Vazhdimi direkt i parimeve të Modulit I në aspektet teknike dhe operative

10

Komplikacione proceduriale kryesore që duhen njohur dhe parandaluar

6

Hapa në protokollin klinik të retrajtimin endodontik

5

Hapa në sekuencën finale të irrigimit të avancuar

- Zgjedhja e instrumentit të duhur — manual apo mekanik — ndikon drejtpërdrejt në ruajtjen e anatomisë dhe në rrezikun e komplikacioneve.
- Dezinfektimi i plotë varet kryesisht nga irrigimi kimik, jo vetëm nga instrumentimi mekanik.
- Cikli i plotë i kujdesit endodontik përfshin retrajtimin dhe vlerësimin afatgjatë të rezultatit, jo vetëm trajtimin fillestar.

INSTRUMENTET MANUALE

K-file, K-Reamer dhe H-file — baza e çdo trajtimi endodontik

Instrumenti	Dizajni	Përdorimi kryesor
K-file	Përdredhje; seksion katror/trekëndësh	Eksplorim, negocim, glide path, instrumentim standard
K-Reamer	Përdredhje me më pak spirale	Zgjerim me rrotullim, kanale relativisht të drejta
H-file (Hedström)	Frezim; seksion konik i mbivendosur	Zgjerim final, largim gutaperke; vetëm tërheqje

Materialet

- Çeliku inox — rezistencë e lartë, fleksibilitet i kufizuar.
- Nikël-Titani (NiTi) — superelasticitet, fleksibilitet superior.


Teknika balanced force

Metoda më efikase për instrumentimin e kanaleve të lakuara — redukton transportimin e kanalit dhe stresin torsional mbi instrumentin.

INSTRUMENTET NiTi DHE KINEMATIKA

Superelasticiteti, memoria e formës dhe sistemet rotary/reciprocating

Kinematika e instrumenteve NiTi



Vetitë kryesore të NiTi

- Superelasticiteti — rikthim në formë pas deformimit.
- Memoria e formës — M-Wire, CM-Wire, heat-treated.
- Fleksibilitet 2–3× më i madh se çeliku inox.

Lodhja ciklike & fraktura torsionale: dy mekanizmat kryesorë të frakturës së instrumenteve NiTi. Respektimi i shpejtësisë dhe torque-ut të rekomanduar, krijimi i glide path-it dhe rikapitulimi periodik reduktojnë ndjeshëm këtë rrezik.

TEKNOLOGJITË MODERNE MBËSHTËTËSE

Apex locator, mikroskop, ultrasonik, obturim dhe planifikim digjital

Apex locator

Saktësi >90–95% brenda ± 0.5 mm nga forameni apikal (gjenerata multifrekuençë).

Mikroskopi operativ

Standardi i artë për lokalizimin e MB2, heqjen e instrumenteve të frakturuar dhe kirurgjinë endodontike.

Ultrasoniku (PUI)

Acoustic streaming rrit depërtimin e NaOCl/EDTA në isthmuse dhe kanale laterale.

Obturimi & digjitali

Gutaperkë e ngrohtë + CBCT/AI/guided endodontics për planifikim më të saktë, gjithmonë si mjete mbështetëse.

KLASIFIKIMI I KOMPLIKACIONEVE PROCEDURIALE

10 komplikacionet kryesore që mund të ndodhin gjatë trajtimit

1. Humbja e gjatësisë së punës

2. Humbja e patencës apikale

3. Bllokimi i kanalit

4. Formimi i ledge

5. Transportimi i kanalit

6. Zip dhe elbow

7. Perforimet

8. Fraktura e instrumenteve

9. Mbipërgatitja apikale

10. Ekstruzioni i NaOCl

Parandalimi universal


- Glide path i sigurt para çdo instrumentimi mekanik.
- Rekapitulim periodik me file #08-#10.
- Ruajtja e patencës apikale gjatë gjithë preparimit.
- Irrigim i bollshëm dhe instrumentim pa presion apikal.
- Kontroll i shpeshtë i gjatësisë së punës me apeks-lokator.

Shumica e komplikacioneve fillojnë nga i njëjti shkak rrënjësor: mungesa e një glide path-i të sigurt.

LEDGE, PERFORIMI DHE TRANSPORTIMI I KANALIT

Gabimet kryesore iatrogjene gjatë instrumentimit të kanaleve të lakuara

Gabimet iatrogjene kryesore gjatë instrumentimit



Perforimet

Proгноza varet nga koha e ndërhyrjes, madhësia e defektit dhe pozicioni. Riparim me materiale biokeramike (MTA, Biodentine).

Fraktura e instrumentit — opsionet

- 1 • Bypass — opsioni më konservativ.
- 2 • Heqja — nën mikroskop, kur përfitimi tejkalon rrezikun.
- 3 • Lënia in situ — me ndjekje periodike.

MBIPËRGATITJA APIKALE DHE AKSIDENTI ME NaOCl

Mbipërgatitja apikale

Zgjerim i tepërt përtej konstrikcionit apikal. Rrit rrezikun e ekstruzionit, dhimbjes postoperative (flare-up) dhe humbjes së barrierës natyrale apikale.

Aksidenti me NaOCl

Dhimbje e menjëhershme, ënjtje e shpejtë, ekimozë, trizmus. Veprimi: ndërpritet irrigimi, shpëlarje me solucion fiziologjik, kompresë e ftohtë 6–24 orë.

Parandalimi i ekstruzionit të NaOCl

Përcaktim i saktë i gjatësisë së punës • gjilpëra me dalje anësore • mosfutje më afër se 1–2 mm nga gjatësia e punës • irrigim i ngadaltë, pa presion.

KUR INDIKOHET RETRAJTIMI ENDODONTIK

Indikacionet klinike dhe shkaqet kryesore të dështimit të trajtimit fillestar

Kur indikohet

- Lezion periapikal i ri ose i rritur.
- Simptoma të vazhdueshme pas trajtimit.
- Obturim i pamjaftueshëm ose kanal i pazbuluar (p.sh. MB2).
- Nevojë për rihapje për qëllime restauruese.

Shkaqet e dështimit

- Intrakanalar — kanal i pagjetur, dezinfektim jo i plotë.
- Ekstraradikular — biofilm periapikal, cist e vërtetë.
- Koronar — mikroinfiltrim nga restaurim i vonuar.
- Procedural — ledge, transportim, perforim i patrajtuar.

VENDIMMARRJA DHE PROTOKOLLI KLINIK

Retrajtim jo-kirurgjik, kirurgji endodontike, ose ekstraksion

Opsioni	Kur indikohet
Retrajtim jo-kirurgjik	Kanal i aksesueshëm; shkaku brenda kanalit
Kirurgji endodontike	Infeksion ekstraradikular; kanal i paaksesueshëm
Ekstraksion	Frakturë vertikale; strukturë e pamjaftueshme

Protokolli klinik: Heqja e restaurimit → Heqja e materialit të vjetër → Ri-negocimi i të gjitha kanaleve → Ri-instrumentimi → Dezinfektim i zgjatur → Ri-obturim & restaurim final.

Prognoza

Dhëmbët pa lezion periapikal paraprak kanë prognozë më të favorshme. Mikroskopi operativ dhe protokollet moderne të irrigimit rrisin ndjeshëm shkallën e suksesit.

NaOCl, EDTA DHE Klorheksidina

Tre irriguesit kryesorë të protokollit të dezinfektimit endodontik

NaOCl (0.5–5.25%)

Irriguesi kryesor — tret inde organike dhe eliminon biofilmin. Efikasiteti varet nga vëllimi, koha e kontaktit dhe aktivizimi.

EDTA (17%)

Agjent kelues për heqjen e smear layer-it. Përdoret si irrigim final, 1–3 minuta.

Klorheksidina (2%)

Plotësuese në ritrajtime ose alergji ndaj NaOCl. Nuk tret inde organike.

Kujdes: mos i përzeni kurrë direkt

NaOCl + EDTA neutralizon aftësinë tretëse; NaOCl + CHX formon precipitat (PCA) që mund të bllokojë tubulat dentinare. Kërkohet gjithmonë një shpëlarje intermediare me solucion fiziologjik.

SEKUENCA FINALE E IRRIGIMIT

Një protokoll i strukturuar, i bazuar në evidencë, për kanalet e vështira

1 NaOCl gjatë gjithë fazës së instrumentimit biomekanik.

2 EDTA 17% për 1–3 minuta — heqja e smear layer-it.

3 Shpëlarje me solucion fiziologjik.

4 Shpëlarje finale me NaOCl për disa sekonda.

5 Tharje e kanalit me kono letre sterile.

Aktivizimi ultrasonik (PUI) i irrigantëve rrit ndjeshëm depërtimin në isthmuse dhe kanale laterale — konsiderohet standard në kanalet e vështira.

KRITERET E SUKSESIT DHE FAKTORËT PROGNOSTIKË

Si mateni suksesin e vërtetë klinik të trajtimit endodontik

Kategoria	Kriteret
I shëruar	Asimptomatik; radiografi normale
Në shërim	Asimptomatik; lezion në reduktim progresiv
Dështim	Simptoma ose lezion i ri/i zmadhuar

Faktorët prognostikë

Paraoperativë: prania/madhësia e lezionit, gjendja e pulpës. **Intraoperativë:** cilësia e dezinfektimit dhe obturimit. **Postoperativë:** cilësia dhe koha e restaurimit koronal final.

Faktori i vetëm më i fortë prognostik: prania e infeksionit (nekrozë me lezion periapikal) para trajtimit — më i rëndësishëm se vetë teknika e obturimit.

KALENDARI I NDJEKJES DHE DËSHTIMI AFATGJATË

Radiografia e ndjekjes dhe shenjat që tregojnë nevojë për rivlerësim

6

muaj — kontroll fillestar

12

muaj — kontroll i dytë

24

muaj — kontroll përfundimtar
(deri në 4 vjet në leziona të mëdha)

Kur konsiderohet dështim afatgjatë

- Shfaqja e një lezioni të ri periapikal, ose rritje e një lezioni ekzistues.
- Simptoma të vazhdueshme (dhimbje, fistulë, ndjeshmëri).
- Zbulim i një komplikacioni të ri (p.sh. frakturë vertikale).

PIKAT KYÇE TË TRAJNIMIT



Instrumentet manuale mbeten thelbësore për glide path dhe patencë apikale, edhe në epokën e sistemeve NiTi mekanike.



Shumica e komplikacioneve proceduriale ndajnë të njëjtin shkak rrënjësor: mungesa e një glide path-i të sigurt.



Suksesi i retrajtimit varet nga heqja e plotë e materialit të vjetër dhe ri-negocimi i të gjitha kanaleve.



Dezinfektimi varet kryesisht nga irrigimi kimik — asnjë sistem instrumentesh nuk e zëvendëson këtë parim.



Infeksioni para trajtimit mbetet faktori i vetëm më i fortë prognostik i njohur në endodonci.



Restaurimi koronal me vulosje të mirë mbetet po aq i rëndësishëm sa vetë trajtimi endodontik.

FALEMINDERIT!

Pyetje dhe diskutim

Lektore: Borana Vrapı

Trajtimi Endodontik i Kanaleve të Vështira · Moduli II

TEMA 1. INSTRUMENTIMI DHE TEKNOLOGJITË MODERNE

Instrumentet manuale, NiTi dhe teknologjitë që rrisin saktësinë klinike

Instrumentet manuale

Instrumenti	Përdorimi kryesor
K-file	Eksplorim, negocim, glide path
K-Reamer	Zgjerim me rrotullim, kanale të drejta
H-file	Zgjerim final, largim gutaperke (vetëm tërheqje)

Instrumentet NiTi

- Superelasticiteti** — rikthim në formë pas deformimit; redukton transportimin.
- Memory e formës** — shfrytëzohet në instrumentet heat-treated (M-Wire, CM-Wire).
- Fleksibiliteti 2-3x** më i madh se çeliku inox — ul forcat anësore.

Apex locator

Saktësi >90–95% brenda ± 0.5 mm nga forameni apikal (gjenerata multifrekuençë). Nuk zëvendëson radiografinë — përdoret në kombinim me të.

Mikroskopi operativ


Standardi i artë për lokalizimin e MB2, heqjen e instrumenteve të fraktuara, riparimin e perforimeve dhe kirurgjinë endodontike.

Ultrasoniku (PUI)

Acoustic streaming është mekanizmi kryesor; rrit depërtimin e NaOCl/EDTA në isthmuse dhe kanale laterale. Maja duhet të lëvizë lirshëm, pa kontakt me muret.

Obturimi & softuerët digjitalë

Gutaperkë e ngrohtë (vertikale/injeksion) ofron adaptim më të mirë në anatomi komplekse se kondensimi lateral. CBCT + AI + guided endodontics rrisin saktësinë e planifikimit, por mbeten mjete mbështetëse të gjykit klinik.




★ Pikat kyçe për praktikën klinike

- Instrumentet manuale mbeten thelbësore për glide path dhe patencë apikale, edhe në epokën NiTi.
- Respektimi gjithmonë shpejtësinë dhe torque-in e rekomanduar nga prodhuesi për të reduktuar rrezikun e frakturës.
- Apex locator, mikroskop dhe ultrasonik janë teknologji plotësuese — jo zëvendësuese të njëra-tjetrës.

TEMA 2. KOMPLIKACIONET DHE MENAXHIMI I TYRE

Klasifikimi, parandalimi dhe menaxhimi i 10 komplikacioneve kryesore



10 komplikacionet proceduriale

1. Humbja e gjatësisë së punës
2. Humbja e patencës apikale
3. Bllokimi i kanalit
4. Formimi i ledge
5. Transportimi i kanalit
6. Zip dhe elbow
7. Perforimet
8. Fraktura e instrumenteve
9. Mbipërgatitja apikale
10. Ekstruzioni i NaOCl

Parandalimi universal

- Glide path i sigurt para çdo instrumentimi mekanik.
- Rekapitulim periodik me file #08–#10 dhe ruajtje e patencës apikale.
- Irrigim i bollshëm dhe instrumentim pa presion apikal.
- Kontroll i shpeshtë i gjatësisë së punës me apeks-lokator.

Fraktura e instrumentit — opsionet

- 1 • Bypass (më konservativ) 2 • Heqja nën mikroskop
3 • Lënia in situ me ndjekje periodike, nëse rreziku i heqjes tejkalon përfitimin.

⚠ Aksidenti me NaOCl

- Shenjat: dhimbje e menjëhershme e fortë, ënjtje e shpejtë, ekimozë, trizmus.
- Veprimi: ndërprisni irrigimin, shpëlani me solucion fiziologjik, kompresë e ftohtë 6–24 orë.

★ Pikat kyçe për praktikën klinike

- Shumica e komplikacioneve fillojnë nga i njëjti shkak rrënjësor: mungesa e një glide path-i të sigurt.
- Prognoza e frakturës/perforimit varet më shumë nga koha dhe cilësia e dezinfektimit të kryer para komplikacionit, sesa nga vetë ngjarja.
- Perforimet mbyllen sot me materiale biokeramike (MTA, Biodentine) me shkallë suksesi të lartë kur diagnostikohen herët.

TEMA 3. RETRAJTIMI ENDODONTIK

Indikacionet, vendimmarrja dhe protokoli klinik i ritrajtimit

Kur indikohet retrajtimi

- Lezion periapikal i ri ose i rritur në dhëmb të trajtuar më parë.
- Simptoma të vazhdueshme pas një trajtimi të kryer.
- Obturim i pamjaftueshëm ose kanal i pazbuluar (p.sh. MB2).
- Nevojë për rihapje për qëllime restauruese (preparim posti).

Vendimmarrja

Opsioni	Kur indikohet
Retrajtim jo-kirurgjik	Kanal i aksesueshëm; shkak brenda kanalit
Kirurgji endodontike	Infeksion ekstraradikular; kanal i paaksesueshëm
Ekstraksion	Frakturë vertikale; strukturë e pamjaftueshme

Shkaqet e dështimit

Faktori	Shembull
Intrakanalar	Kanal i pagjetur, dezinfektim jo i plotë
Ekstraradikular	Biofilm periapikal, cist e vërtetë
Koronar	Mikroinfiltrim nga restaurim i vonuar
Procedural	Ledge, transportim, perforim i patrajtuar

Protokoli klinik (përmbledhje)

1 • Heqja e restaurimit → 2 • Heqja e materialit të vjetër → 3 • Ri-negocimi i të gjitha kanaleve → 4 • Ri-instrumentimi → 5 • Dezinfektim i zgjatur (+ Ca(OH)₂ nëse nevojitet) → 6 • Ri-obturim & restaurim final.

Proгноza

Dhëmbët pa lezion periapikal paraprak kanë prognozë më të favorshme. Mikroskopi operativ dhe protokollat moderne të irrigitimit rrisin ndjeshëm shkallën e suksesit të retrajtimit.

★ Pikat kyçe për praktikën klinike

- Suksesi i retrajtimit varet nga heqja e plotë e materialit të vjetër dhe ri-negocimi i të gjitha kanaleve — jo thjesht zëvendësimi i materialit të obturimit.
- Poste të cementuara dhe instrumente të fraktuara nga trajtimi i parë kërkojnë kujdes të shtuar dhe shpesh mikroskop operativ.
- Vlerësoni gjithmonë me CBCT në rastet e dyshimta për kanale të papërpunuara ose çarje radikulare.

TEMA 4. IRRIGIMI DHE DEZINFEKTIMI I AVANCUAR

NaOCl, EDTA, klorheksidina dhe protokoli final i irrigit

Hipokloriti i natriumit (NaOCl)

Irriguesi kryesor — tret inde organike dhe eliminon biofilmin. Përqendrimi klinik: 0.5%–5.25%. Përqendrimet më të larta = efikasitet më i lartë, por rrezik më i madh në ekstruzion.

EDTA (17%)

Agjent kelues për heqjen e smear layer-it. Përdoret si irrigit final, 1–3 minuta, para shpëlarjes përfundimtare me NaOCl.

Klorheksidina (CHX 2%)

Plotësuese në ritrajtime ose në alergji të dokumentuar ndaj NaOCl. Ka substantivitet të mirë, por **nuk** tret inde organike.

Sekuenca finale e irrigit

1 · NaOCl gjatë instrumentimit → 2 · EDTA 17% (1–3 min) → 3 · Shpëlarje me solucion fiziologjik → 4 · Shpëlarje finale me NaOCl → 5 · Tharje me kono letre.

Aktivizimi i irrigitëve

PUI (Passive Ultrasonic Irrigation) rrit ndjeshëm penetrimin në isthmuse, kanale laterale dhe delta apikale — konsiderohet standard në kanalet e vështira (shih Temën 1.6).

⚠ Kujdes: mos i përzieri kurrë direkt

- NaOCl + EDTA** — reagimi neutralizon aftësinë tretëse të hipokloritit.
- NaOCl + CHX** — formon precipitat (PCA) që mund të bllokojë tubulat dentinare.
- Gjithmonë një shpëlarje intermediare me solucion fiziologjik ndërmjet irrigitëve të ndryshëm.

★ Pikat kyçe për praktikën klinike

- Dezinfectimi varet kryesisht nga irrigimi kimik, jo nga vetë instrumentimi mekanik — asnjë sistem instrumentesh nuk e zëvendëson këtë parim.
- Vëllimi total i irrigitit dhe koha e kontaktit ndikojnë në efikasitetin po aq sa vetë përqendrimi.
- Aktivizimi ultrasonik duhet konsideruar standard në çdo kanal të klasifikuar si të vështirë.

TEMA 5. VLERËSIMI I REZULTATIT DHE SUKSESI AFATGJATË

Kriteret e suksesit, faktorët prognostikë dhe ndjekja radiografike

Kriteret e rezultatit

Kategoria	Kriteret
I shëruar	Asimptomatik; radiografi normale
Në shërim	Asimptomatik; lezion në reduktim progresiv
Dështim	Simptoma ose lezion i ri/i zmadhuar

Faktorët prognostikë

- Paraoperativë** — prania/madhësia e lezionit, gjendja e pulpës.
- Intraoperativë** — cilësia e dezinfektimit dhe obturimit; komplikacione të mundshme.
- Postoperativë** — cilësia dhe koha e restaurimit koronal final.

Kalendari i ndjekjes

6 muaj — kontroll fillestar • **12 muaj** — kontroll i dytë • **24 muaj** (ose deri në 4 vjet në leziona të mëdha) — kontroll përfundimtar.

Faktori më i fortë prognostik

Prania e infeksionit (nekrozë me lezion periapikal) para trajtimit mbetet faktori i vetëm më i fortë i njohur në endodonci — më i rëndësishëm se vetë teknika e obturimit.

Kur konsiderohet dështim

- Lezion i ri periapikal, ose rritje e një leziona ekzistues.
- Simptoma të vazhdueshme (dhimbje, fistulë, ndjeshmëri).
- Zbulim i një komplikacioni të ri (p.sh. frakturë vertikale).

★ Pikat kyçe për praktikën klinike

- Vlerësimi i rezultatit kombinon gjithmonë kriteret klinike dhe radiografike, brenda një kalendari 6–24+ muaj.
- Një lezion rezidual i vogël në kontrollin e 12 muajve nuk përbën domosdoshmërisht dështim nëse tregon reduktim progresiv.
- Restaurimi koronal me vulosje të mirë mbetet po aq i rëndësishëm sa vetë trajtimi endodontik.